



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Atëherë, siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor po fillohet mbledhja e parashikuar për datën 18 qershor 2020.

Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni vënë në dijeni me rendin e ditës sot nga mbledhja do merren për shqyrtim 13 çështje, konkretisht:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”.

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”.

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”.

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”.

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”.

13. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Komision i cili do informojë Këshillin edhe mbi gjendjen e çështjeve që janë nëpër gjykata.

Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër për të shtuar ose për të diskutuar paraprakisht, atëherë unë do të filloja me rendin e ditës, lidhur me shqyrtimin e projektvendimit të parë. Dëshiroj t'ia jap fjalën zotit Ilir Toska.

(Kërkon fjalën fillimisht zonja Brikena Ukperaj.)

Atëherë, fjalën e ka zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Diskutimi që unë kam në fakt është parimor dhe vlerësoj që duhet ta bëj në këtë moment me qëllim që të mos diskutohet në momentin kur të merren në analizë çështje të caktuara ose kandidatura të caktuara për ngritjen në detyrë. Pra diskutimi që unë kam lidhet me kushtin e përvojës specifike, profesionale, që kërkohet për çdo pozicion të shpallur, dhe kjo është në përgjithësi për të gjitha rastet e ngritjes në detyrë, pavarësisht se shqetësimi im ka lindur kryesisht për shkak të kandidaturave që kemi shpallur për Gjykatën e Lartë.

Ne sot do të kalojmë disa projekt-akte të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës që lidhen me verifikimin e plotësimit të tre prej kriterëve formale të kandidimit, një prej të cilëve i përket pikërisht përvojës profesionale të përgjithshme dhe në veçanti përvojës profesionale specifike për fushën në të cilën janë shpallur pozicionet e lira.

Kushtetuta vendos si rregull për promovimin në Gjykatën e Lartë pasjen e jo më pak se 13 viteve përvojë profesionale, por nga ana tjetër përcakton ose me anë të një rezerve ligjore i delegon ligjvënësit që të përcaktojnë kriterë të tjera si dhe procedurën, mbi bazën e të cilit do të bëhet përzgjedhja e kandidatëve.

Në ligjin “Për organet e qeverisjes...”, neni 85, parashikohet se përzgjedhja e kandidatëve për Gjykatën e Lartë do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për Statusin. Në ligjin për Statusin, në nenin 47, parashikon jo vetëm periudhën e domosdoshme të përgjithshme profesionale për çdo pozicion që konsiderohet ngritje në detyrë, por edhe atë specifike.

Në rastin e Gjykatës së Lartë, parashikohet që magjistrati mund të ngrihet në këtë detyrë nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se 13 vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën 5 vjet në fushën e së drejtës përkatëse, të përshtatshme për pozicionin e lirë.

Në ligj nuk parashikohet se ku ose si duhet të llogaritet përvoja specifike profesionale 5-vjeçare në fushën e së drejtës përkatëse.

Ne kemi shpallur pozicione për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe njëkohësisht kemi shpallur pozicione për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke specifikuar edhe fushat përkatëse administrative dhe atë civile.

Shqetësimi që unë kam lidhet me faktin se, duke filluar që sot, do fillojmë që të ngremë një sistem të karrierës së gjyqtarit. Referuar ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe parimeve të sanksionuara në të, vendoset ose parashikohet krijimi ose nxitja e specializimit të gjyqtarëve në gjykatat ku ata ushtrojnë funksionin. Në këtë aspekt, parashikohet që Gjykata e Lartë do të gjykojë në tre kolegje: kolegjin civil, kolegjin administrativ dhe kolegjin penal; ku kolegji administrativ kryesisht, do të shqyrtojë rekursat ndaj vendimeve të gjykatave administrative.

Ne kemi të krijuar gjykatat administrative që nga viti 2013. Pra që nga viti 2013 e deri më sot, për 7 vjet, çështjet administrative shqyrtohen nga ana e një gjykate të posaçme, e cila ka rregulla të ndryshme të funksionimit, jo vetëm për sa i përket konceptit të juridiksionit por edhe të mënyrës se si zhvillohet gjykimi administrativ.

Neni 47/5, për mënyrën se si është formuluar, në qoftë se do t’i bëjmë një interpretim gramatikor dispozitës, mundëson të gjithë gjyqtarët që, pavarësisht se kur i kanë gjykuar çështjet administrative, pra edhe përtej 13-vjetshit, të aplikojnë për të shkuar në Gjykatën e Lartë në pozicionet e së drejtës administrative.

Nga ana tjetër, nëse do t’i referohemi dispozitave që parashikojnë lëvizjet paralele, një gjyqtar i shkallës së parë, e ka të pamundur që të shkojë në gjykatë administrative sepse në 5 vitet e fundit ai duhet të ketë gjykuar së paku 1 vit të drejtën administrative ose çështje administrative dhe një gjë e tillë është e pamundur në kushtet kur kemi 7 vjet gjykatë administrative. Pra krijohet një pabarazi. Nëse një gjyqtar i shkallës së parë nuk mund të shkojë dot me lëvizje paralele në gjykatë administrative, me interpretimin e nenit 47, pika 5 ai mund të shkojë në kolegjin administrativ.

Nga ana tjetër, nëse i referohemi nenit 42, pika 5 të ligjit për Statusin, që bën fjalë për lëvizjet paralele në Gjykatën e Apelit Administrativ, kushti i vendosur nga ligji është që gjyqtari të ketë punuar për të paktën 5 vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet

administrative. Nga interpretimet që i bëjmë kësaj dispozite, në momentin që ne shpallëm pozicionet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Administrativ, ramë dakord që kjo nuk mund të zbatohet për gjykatat e apeleve sepse asnjë gjyqtar në gjykatën e apelit nuk ka 5 vjet që të ketë gjykuar çështje administrative në 5 vitet e fundit dhe vlerësuam që vendet në Gjykatën e Apelit Administrativ mund të plotësohen vetëm nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Një gjyqtar i apelit të zakonshëm nuk mund të shkojë dot me këtë logjikë në Gjykatën e Apelit Administrativ, por sipas nenit 47/5, i ka të gjitha mundësitë nëse pesëvjeçari shtrihet përtej periudhës 13-vjeçare, që ai të shkojë në Gjykatën e Lartë, si pjesë e kolegjit administrativ.

Ajo që mua më shqetëson në këtë moment është që, mënyra se si ne do të vendosim dhe do të procedojmë sot, për plotësimin ose jo të kushteve lidhur me përvojën profesionale specifike, do të afektojë në vazhdimësi të gjithë karrierën e gjyqtarëve dhe nëse do të interpretohet që 5-vjeçari mund të shtrihej përtej periudhës 13-vjeçare, që mund të jetë periudha e fundit, çka do të thotë që një gjyqtar mund të ketë 20 vjet përvojë profesionale dhe 5-vjeçarit e pozicionit e ka në vitet e para dhe më tej mbi 15 vjet ose 16 vjet ai nuk ka gjykuar çështje të kësaj natyre, në vlerësimin tim rrezikohet ose nuk ka një trajtim të barabartë të gjyqtarëve për sa i përket karrierës profesionale dhe jo vetëm kaq, por ndoshta do të krijohet dhe nuk do të ketë nxitje për ta krijuar këtë karrierë.

Ne në rregullore në fakt, nuk kemi bërë asnjë parashikim se si dhe kur do të llogaritet 5-vjetshi i përvojës profesionale.

Nuk e di, -doja edhe mendimin e kolegëve.

Në vlerësimin tim, nuk mundet që një gjyqtar që ka një përvojë profesionale 20-vjeçare dhe 5-vjetshin e kërkuar për pozicione specifike i ka tej 13-vjetshit, pra ka 5 vitet e para të detyrës, të promovohet si gjyqtar i një fushe tjetër nga ajo që ka ushtruar funksionin. Po marrë për shembull një gjyqtar që ka gjykuar çështje penale për një periudhë 15-vjeçare dhe asnjë çështje administrative ose çështje civile, duhet të ndjekë karrierën e gjyqtarit brenda fushës penale dhe jo asaj administrative ose civile. Ndoshta do të ishte e nevojshme që para se ne të merrnim në analizë secilin nga kandidatët dhe të analizonim verifikimin e plotësimit të përvojës profesionale specifike, lidhur me këtë dispozitë ligjore, të kërkohet një mendim nga misionet tona mbështetëse, për mënyrën e

interpretimit logjik dhe sistematik të kësaj dispozite referuar dispozitave të tjera që rregullojnë karrierën e gjyqtarit, qoftë transferimin paralel në gjykatën e apelit, qoftë lëvizjen paralele në shkallë të parë, me qëllim që të kemi një trajtim të barabartë të gjyqtarëve, por edhe një ndërtim të karrierës së gjyqtarit, mbi bazën e parimeve që parashikon ligji, i cili është ai i specializimit të gjyqtarëve.

Ky ishte një diskutim në parim.

Nuk e di se çfarë mendimi kanë kolegët.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Fjalën e ka zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Edhe unë ndaj shqetësimit të zonjës Ukperaj në lidhje me situatën aktuale dhe të kandidaturave për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë. Unë jam i mendimit që kështu siç është i formuluar ligji për Statusin, paragrafi 5 i nenit 47, që e referoi zonja Ukperaj dhe për ekonomi kohore nuk po e ripërsëris, kjo dispozitë i njeh të drejtën çdo gjyqtari që ka ushtruar funksionin për mbi 13 vjet në nivele më të ulëta dhe që gjatë kësaj periudhe ka gjykuar çështje në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, për të paktën 5 vjet, që të kandidojë për të emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Kështu siç është formuluar - e ritheksoj këtë - dispozita nuk specifikon periudhën kohore përgjatë së cilës duhet të jetë ushtruar funksioni në fushën e së drejtës përkatëse, të përshtatshme për pozicionin e lirë, për të paktën 5 vjet. Nuk thotë, as në fillim, as në mes, apo gjatë viteve të fundit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit. Nga ana tjetër, ashtu siç shumë drejt e referoi zonja Ukperaj, paragrafi 6 i nenit 43, parashikon që magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë 5 viteve të fundit, nuk ka të paktën 1 vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë. Në këtë dispozitë, në dallim nga e mëparshmja, legjislatori e shpreh qartë vullnetin e tij që, viti i përvojës profesionale në fushën specifike të së drejtës, për pozicionin e lirë, duhet të jetë i shtrirë në kohë përgjatë 5 viteve të fundit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit.

Aktualisht, në situatën ku ndodhemi, kandidojnë për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, në fushën e së drejtës civile dhe të drejtës administrative, gjyqtarë që kanë

ushtruar funksionin për mbi 13 vjet në nivele më të ulëta dhe që gjatë kësaj periudhe kanë gjykuar çështje civile dhe administrative për të paktën 5 vjet, por ama shtrirja kohore e kësaj periudhe 5-vjeçare nuk është përgjatë viteve të fundit, madje, siç e theksoi edhe zonja Ukperaj, është përgjatë viteve të para të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit.

Si e vlerësoj unë këtë? – Në gjykimin tim, ky fakt nuk mund të çojë në mohimin e të drejtës këtyre gjyqtarëve për të zhvilluar karrierës (në rastin konkret, duke u emëruar në Gjykatën e Lartë), për shkak se përvoja e tyre në fushën e të drejtës civile apo administrative nuk shtrihet përgjatë 5 viteve të fundit.

Sipas vlerësimit tim, kjo është një e drejtë e fituar me ligj, në kuptim të paragrafit 5 të nenit 47 të ligjit për Statusin, dhe çdo vendim që do të cenonte këtë të drejtë, do cenonte njëkohësisht parimin e sigurisë juridike, parim themelor në një shtet të së drejtës, sepse gjyqtarët, përveç garancive që gëzojnë për shkak të funksionit që ata kryejnë, gëzojnë edhe garanci si individë.

Nga ana tjetër, neni 138 i Kushtetutës parashikon që, pagat dhe përfitimet e tjera të gjyqtarëve nuk mund të ulen, përveç tre rasteve përjashtimore që i rendit kjo dispozitë, që janë: marrja e masave ekonomiko-financiare në raste emergjencash kombëtare; kthimi në detyrën që gjyqtari mbante përpara emërimit; dhe dhënia e një mase disiplinore ose vlerësimi “i pamjaftueshëm” profesionalisht. Por në situatën konkrete nuk ndeshim asnjë prej këtyre rasteve.

Në lidhje me përfitimet e gjyqtarit, desha të sjell në vëmendjen tuaj vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 40, të vitit 2014, ku gjykata shprehet se:

“Neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit (e theksoj), të mos ndryshohen me efekt negativ.” – dhe vendimmarrja jonë eventuale, që do u mohonte këtë përfitim, prej zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, në thelb, nuk do bënte gjë tjetër veçse do ndryshonte me efekt negativ, mënyrën se si është formuluar paragrafi 5 i nenit 47 të ligjit për Statusin.

Mendoj gjithashtu që mohimi i të drejtës këtyre gjyqtarëve për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, do cenonte edhe parimin e sigurisë juridike, parë kjo nga këndvështrimi i të drejtave që ata tashmë i kanë fituar me ligj, në lidhje me karrierën, e cila si element i statusit të gjyqtarit, garantohet nga neni 138 i Kushtetutës, - që e përmenda, dhe do të cenonte edhe parimin e barazisë përpara ligjit, të parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 18 të Kushtetutës, duke krijuar kështu pabarazi ndërmjet gjyqtarëve me vjetërsi, kualifikim, nivel profesional apo integritet moral të njëjtë, vetëm për shkak të periudhës së shtrirjes kohore të përvojës 5-vjeçare.

Dua të sjell në vëmendje edhe paragrafin e parë, të nenit 4, të Kartës Evropiane për statusin e gjyqtarit, ku karrierën e përfshin si një nga garancitë që gëzon gjyqtari, së bashku edhe me garanci të tjera siç janë paga, pensioni, përzgjedhja, rekrutimi dhe emërimi nga një entitet i pavarur. Ky paragraf sanksionon që nëse nuk bazohet në vjetërsi, sistemi i promovimit është i bazuar ekskluzivisht në cilësitë dhe meritat që konstatohen gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit, nëpërmjet vlerësimeve objektive të kryera prej një apo disa gjyqtarëve dhe të diskutuara me gjyqtarin në fjalë, - dhe këtu e përfundoj citimin e Kartës Evropiane për statusin e gjyqtarit.

Kandidatët që vlerësohen se gëzojnë cilësitë dhe meritat dhe përmbushin kriterin ligjor të përvojës profesionale (ritheksoj), ashtu siç i është i formuluar ky kriter në ligjin aktual, nuk mund të pengohen për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, për shkak se, shtrirja kohore e përvojës 5-vjeçare, nuk është përgjatë viteve të fundit. Unë e kuptoj fare mirë dhe ndaj me kolegen Ukperaj shqetësimin e saj që ka mendimin se interesi publik dikton kufizimin e karrierës në rastin konkret, me qëllim rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet emërimit të gjyqtarëve që kanë një përvojë të kohëve të fundit në fushën e të drejtës civile dhe të drejtës administrative.

Nëpërmjet vendosjes së kushtit që, shtrirja kohore e përvojës 5-vjeçare duhet të jetë përgjatë viteve të fundit, duket se synohet në fakt pajisja e gjyqtarit me një eksperiencë unike që arrihet vetëm duke shërbyer efektivisht në fushën e të drejtës civile apo administrative, gjatë viteve të fundit. Megjithatë, unë dua të risjell në vëmendjen tuaj që, ne së bashku, nuk e kemi konsideruar këtë si pengesë për caktimin e gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, për të gjykuar çështje të caktuara në gjykatat e posaçme, si edhe anasjelltas. Në lidhje me këtë, të paktën personalisht, nuk kam hezituar

për asnjë moment gjatë vendimmarrjes tonë, duke qenë i bindur që gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë, janë gjyqtarë të kompetencës së përgjithshme, të aftë të gjykojnë çështje që lidhen me fusha të ndryshme të së drejtës, pavarësisht dhomës apo seksionit ku ata mund të bëjnë pjesë, në gjykatat ku ushtrojnë detyrën në mënyrë të përhershme. Për sa kohë që Kushtetuta përcakton që, në Gjykatën e Lartë emërohen si gjyqtarë juristë të spikatur, të cilët vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor, siç bëmë neve para pak kohësh, unë vet nuk shikoj ndonjë pengesë që edhe gjyqtarët që plotësojnë kriteret e paragrafit 5 të nenit 47 të ligjit për Statusin, pra që kanë ushtruar funksionin për mbi 13 vjet në nivele më të ulëta dhe që gjatë kësaj periudhe kanë gjykuar për 5 vjet çështje në fushën e të drejtës civile dhe të drejtës administrative, të emërohen në Gjykatën e Lartë.

Nëse legjislatori do të kishte synuar vendosjen e kushtit, që shtrirja kohore e përvojës profesionale specifike 5-vjeçare duhet të jetë përgjatë viteve të fundit, duhet ta kishte bërë këtë në mënyrë të shprehur, siç edhe e ka bërë tek paragrafi 6 i nenit 43, - që zonja Ukperaj e citoi.

Në vlerësimin tim, vendimmarrja e Këshillit, duhet të bazohet në ligjin siç është hartuar nga legjislatori, jo në ligjin siç Këshilli mund të mendojë se do duhet të ishte hartuar prej legjislatorit.

Edhe, i referohem edhe vendimmarrjes më të fundit të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (vendim i para tre ditëve në fakt), me nr. 17-1618, i datës 15.06.2020, në çështjen “Bostock kundër Clayton County” në Georgia, në të cilin gjykata është shprehur se (po citoj tani nga vendimi i gjykatës): “Kufizimet e imagjinatës së hartuesve të ligjit nuk përbëjnë shkak për të shmangur urdhërimet e ligjit. Kur dispozitat e shkruara të një ligji na japin një përgjigje, ndërsa arsye të tjera jashtë tekstit sugjerojnë diçka tjetër, këtu nuk ka diskutim. Vetëm fjala e shkruar është ligj dhe të gjithë individët kanë të drejtë të përfitojnë prej tij”.

Bazuar në këto që sapo diskutova, duke vlerësuar paragrafin e 5 të nenit 47 të ligjit për Statusin, së bashku me kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi si dhe aktet ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarëve, unë personalisht jam i mendimit që kufizimi që do i bëhej gjyqtarëve në rastin konkret, duke ndaluar ngritjen e tyre në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë, do iu mohonte atyre të drejtën për të zhvilluar

karrierën e tyre, duke cenuar një të drejtë të fituar me ligj si dhe do të cenonte parimet e sigurisë juridike dhe të mosdiskriminimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Fjalën ia jap zotit Bici, i cili e ka kërkuar, dhe më pas vazhdojmë me zonjë Kadi dhe me zonjën Ukperaj sërish.

Medi Bici: Zonja Kryetare, për sa i përket Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda desha të bëj një sqarim.

Ajo është krijuar në vitin 2004 dhe pikërisht në këtë vit dhe në vitin 2005, të gjithë gjyqtarët e saj kanë qenë të komanduar me afate 3-mujore në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe nga kjo kohë, deri në vitin 2010, ata kanë marrë pjesë në të gjitha shqyrtimet e çështjeve të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës së Apelit Ushtarak, Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Vlorë. Pas largimit tim në Gjykatën e Lartë ato e kanë shtrirë veprimtarinë edhe në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Pra, ne duhet të kemi parasysh edhe këto fakte, që shumë prej gjyqtarëve kanë qenë të komanduar dhe për një kohë të gjatë kanë punuar edhe në civile dhe në penale dhe nuk i bie që ata të kenë pasur një përvojë para 15 vjetësh në çështje civile ose në çështjet administrative.

Këtë desha të bëj me dije Këshillit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Atëherë, fjalën ia kaloj zonjës Kadi!

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Unë nuk dua t'i heq asnjë presje diskutimit që bëri zoti Muharremaj, jam shumë dakord me arsyetimin dhe konkluzionin e tij, thjesht dua të shtoj diçka. Fakti që një dispozitë tek lëvizja paralele ka vendosur këtë rregull, kjo ne nuk mund të na bëjë të ndryshojmë të gjithë filozofinë apo edhe interpretimin e pjesës tjetër të lëvizjeve paralele apo të ngritjes në detyrë, aq më tepër për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Edhe një fakt tjetër që dua ta theksoj është që, në kushtet ku është sistemi gjyqësor shqiptar, edhe sikur të ishte në ditët e tij më të mira, Shqipëria për shkak të numrit të vogël të popullsisë dhe gjyqtarëve, nuk e ka luksin që të ketë këto lloj ndarjesh kaq të detajuara, aq më tepër në situatën që është sot sepse në qoftë se ne sot do guxonim e do bënim këtë interpretim ekstra ligjor të dispozitës, ne do përfundonim me një listë të emrave të paracaktuar që do shkonin në Gjykatën e Lartë sepse këto kritere kaq specifike, kam përshtypjen që nuk i plotësojnë dot as një numër kandidatësh baras me vendet, kështu që edhe për këtë arsye unë jam kategorikisht kundër, pra propozimin që bëri Brikena. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Më fal, se nuk kuptova çfarë propozimi bëra?

Çfarë propozimi ju konceptuat që bëra?

Brunilda Kadi: Diskutimin pra, që të interpretojmë ligjin në frymën sipas nenit 43, pika 6, pra të kërkojmë përvojën specifike në vitet e fundit. Unë kështu e perceptova.

Brikena Ukperaj: Jo! Nuk ishte ky propozimi im.

Propozimi im ishte që të mbajmë një qëndrim lidhur me kohëzgjatjen dhe shtrirjen kohore të afatit 5-vjeçar. Nuk thashë në asnjë moment që ky duhet të jetë 5-vjeçari i fundit. Mund të jetë 5-vjeçar brenda 13 viteve të fundit.

Brunilda Kadi: E pra, këtë kuptova edhe unë, këtë që po thua tani.

Brikena Ukperaj: Nuk e thashë në asnjë moment që duhet të jenë 5 vitet e fundit.

Brunilda Kadi: Jo 5 vitet e fundit. As unë nuk e thashë këtë Brikena.

Nuk e kuptova dhe nuk thashë që ishte 5 vitet e fundit. Po bëhet fjalë në përcaktimin e periudhës, brenda 13 viteve të ishte kjo 5. Siç e the tani, -kështu e kuptova.

Brikena Ukperaj: Mund të jetë që, në qoftë se Këshilli mendon që nuk ka rëndësi fare se kur i ka ushtruar 5 vitet, mund t'i ketë ushtruar edhe para 13 vjetëve, edhe para 15 vjetëve. Unë vlerësova që ne duhet ta ngremë si diskutim sepse është e rëndësishme sot që të fillojmë të ndërtojmë karrierën e gjyqtarit. Nëse nuk do të kishte fare rëndësi shtrirja kohore e 5-vjeçarit, nuk e kuptoj pse ne kemi shpallur pozicione të caktuara të së drejtës në Gjykatën e Lartë. Mos t'i shpallim fare...

Brunilda Kadi: E thotë ligji që t'i shpallësh me pozicione ato Brikena.

Brikena Ukperaj: Ka një logjikë ligji për të cilën e shpall sepse ne kërkojmë gjyqtarët më profesionistë të fushës dhe e dimë shumë mirë që Gjykata Administrative ka

filluar të funksionojë në vitin 2013 dhe asnjë gjyqtar nuk ka gjykuar çështje administrative. Është krijuar një gjykatë e posaçme me juridiksion të posaçëm, me një koncept të ndryshëm të zhvillimit administrativ.

Brunilda Kadi: E pra, dhe unë kuptova ekzakt këtë gjë që po thoni ju tani, ekzakt kështu e kuptova dhe thashë, sepse që duhet të jetë 5 vjet brenda 13 vjetëve, ndërkohë që kandidati ka 25 vjet përvojë, e vetmja logjikë që shkon në arsyetimin tuaj është që këto 5 vjet të jenë në këto 13 vitet e fundit, se ndryshe është absurde pastaj. Këto 13 vjet ku janë? –Se ai ka 25 për shembull. Ju sugjeroni që 13 vitet të jenë të fundit, siç thuhet për Gjykatën Administrative.

Unë ju kuptova shumë mirë dhe e thashë arsyen edhe ligjore, që nuk qëndron, por edhe praktike Brikena, se kemi shumë pak gjyqtarë në sistem dhe i bie që t'i kemi emrat e paracaktuar. Ky i dyti ishte një argument praktik. I pari, siç e thashë, ishte ligjor.

Brikena Ukperaj: Lidhur me efektet që mund të shkaktojë ky interpretim, se mund të kemi gjyqtarë të paracaktuar ose jo, mua nuk më shkon si logjikë sepse sot nuk di të them se kush janë gjyqtarët, por mund të them që barazi në trajtimin e gjyqtarëve nuk e garanton vetëm neni 47, pika 5, por e garantojnë të gjitha dispozitat për statusin dhe e gjithë logjika mbi të cilën janë krijuar ligjet dhe është ndërtuar karriera e gjyqtarit.

Ne kemi çuar në Gjykatën e Lartë dhe do çojmë 4 juristë të spikatur, të cilët në 15 vitet e tyre duhet të kishin shfaqur njohuri dhe nivel shumë të lartë profesional të dedikuar në fushën e së drejtës, dhe unë mendoj që edhe këta gjyqtarë që duhet të shkojnë në Gjykatën e Lartë, që është gjykata më e lartë, duhet të jenë gjyqtarë të specializuar në fushën e së drejtës.

Nga ana tjetër, a ju duket logjike që një gjyqtar i shkallës së parë të mos ketë mundësi të bëjë lëvizje paralele në gjykatën e shkallës së parë administrative, po të ketë mundësi që të shkojë në kolegjin administrativ të Gjykatës së Lartë. Një gjyqtar sot që është sot në gjykatën e shkallës së parë, nuk shkon dot të gjykojë në gjykatën e shkallës së parë administrative sepse nuk ka 1 vit përvojë në 5 vitet e fundit, por ama, ky gjyqtar, edhe pse mund të ketë 20 vjet dhe këto 5 vjet i ka para 15 viteve, kualifikohet për të shkuar në Gjykatën e Lartë. Mua kjo gjë nuk më qëndron në arsyetimin tim logjik, për mënyrën se si duhet të trajtohet karriera e gjyqtarit dhe barazia në trajtimin e karrierës së gjyqtarit.

Nëse në kolegjin administrativ të Gjykatës së Lartë do shkojnë gjyqtarë që ia kanë dedikuar punën e tyre të 15 viteve gjykatës penale, do shkojnë në kolegjin administrativ, do shkojnë edhe në kolegjin penal, - karriera e gjyqtarit administrativ ku do shkojë? Pra shqetësimi im është edhe më i gjerë sesa situata faktike në të cilën ndodhet sistemi sepse do vendosim parimet për sot edhe për mot. Jam shumë koshiente për mënyrën se si është ndërtuar neni 47.

Zoti Muharremaj ka shumë të drejtë, edhe pse unë nuk e shikoj në aspektin e përfitimit këtë gjë që ata e kanë përfituar me ligj, sepse askush nuk i mohon një gjyqtari penalist të promovojë dhe të zhvillojë karrierën në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, nuk i mohohet e drejta për të shkuar në Gjykatën e Lartë, por kur flasim për pozicione specifike, duhet të shkojnë gjyqtarët që kanë kontribut në pozicionin specifik, që edhe gjyqtari administrativ, ta ndërtojë karrierën e tij gradualisht në fushën administrative, gjyqtari civil në fushën civile, gjyqtari penal në fushën penale. Në qoftë se do të lejojmë që pavarësisht se kur kanë gjykuar çështje civile, mjafton t'i kenë gjykuar për 5 vite, pavarësisht edhe sasisë (se ky është një diskutim tjetër) dhe në 13 vitet e fundit nuk kanë gjykuar asnjë çështje në fushën në të cilën ata kandidojnë, atëherë në vlerësimin tim nuk do të ishte përzgjedhje profesionale për pozicionin që kërkon Gjykata e Lartë. Gjithsesi, secili nga ne ka këndvështrimin e vet, nuk është thjesht një interpretim gramatikor që i bëj dispozitës, por ndoshta edhe një interpretim logjik, bashkohem edhe me interpretimin e bërë nga zoti Muharremaj, por mendoja që nga secili nga ne, ose si Këshill, të dilnim me një qëndrim të përbashkët, me qëllim që në momentin kur të diskutojmë kandidatura specifike, ta kemi të paracaktuar qëndrimin dhe jo në çdo rast në veçanti. Prandaj propozova që mund t'i marrim edhe një opinion misioneve të cilët kanë qenë prezent në momentin e hartimit të ligjit, që cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit për këtë pjesë. Ky ishte i gjithë diskutimi.

Ilir Toska: Diskutimi që shtroi zonja Ukperaj në fakt nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me Këshillin, në kuptimin që është Këshilli ai që mund të vendosë për kriteret. Kriteret i ka përcaktuar ligji, Kushtetuta ia ka deleguar ligjvënësit të caktojë kriteret e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë. Është ligji që ka përcaktuar kriteret për ngritjen në detyrë në të gjithë gjykatat, qoftë në Gjykatat e Posaçme, qoftë për gjykatën e apelit, përfshi edhe

Gjykatën e Lartë. Nuk ka asnjë autorizim nga ligji që Këshilli të mund të vendosë kritere të tjera shtesë apo brenda kritereve që ka vendosur ligji, të kufizojë afate kohore sa i përket përvojës specifike. Kjo ka qenë arsyeja që edhe në rregulloren që Këshilli ka miratuar sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, nuk ka një rregullim specifik për këtë sepse nuk ka autorizim nga ligji që ta bëjë këtë gjë Këshilli. Mënyrën se si ligji ka përcaktuar kriterin e ngritjes në detyrë në lidhje me përvojën profesionale minimale, mundet që një gjyqtar, pavarësisht kohës kur e ka përvojën specifike, të kandidojë dhe të promovohet edhe në Gjykatën e Lartë. Mbase do të ishte mirë që të ishte brenda një periudhe fundore kjo përvojë specifike, nisur nga qëllimi i ligjvënësit për profilizimin e gjyqtarëve, por edhe për kontributin dhe dobishmërinë e përvojës që ai ka që gjykatën ku do të çohet nëpërmjet ngritjes në detyrë. Por në momentin që ligji nuk e ka konsideruar këtë mënyrë të shprehur, nëse ne do ta bëjmë këtë gjë për raste individuale, do të ishim në kapërcim të kërkesave të ligjit. Prandaj, nuk mendoj se mund t'i kërkojmë edhe një opinion as misioneve që ne na asistojnë, sa kohë ligji është i qartë, i shkruar, pavarësisht këndvështrimeve që ne ndajmë lidhur me dobishmërinë e kufizimit në kohë të përvojës specifike. Nuk e di se si mund të ndodhë tani kjo gjë, në momentin që ne kemi filluar procedurën dhe i bie që të ndryshojmë rregullat gjatë zhvillimit të procedurës.

Edhe një herë theksoj që, ne mbase shqetësimin që kemi mund t'ia përcjellim Kuvendit, nëse ai ka ometuar, por nuk mendoj që ne nuk duhet ta respektojmë atë që ligji thotë dhe të konsiderojmë një kriter tjetër shtesë, sa kohë ligji nuk e ka thënë këtë gjë. Faleminderit!

Erjon Muharremaj: Mundem?

Naureda Llagami: Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në vijim të diskutimeve edhe të zonjës Ukperaj edhe të zotit Toska, siç e përmenda edhe në diskutimin e parë që bëra, e ndaj shqetësimin e bërë nga zonja Ukperaj për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve në fushat e tyre specifike të specializimit, por diskutimi që bëra më parë referohej për ligjin ashtu siç është formuluar sot. Thënë këtë,

unë jam dakord me zotin Toska që shqetësimin tonë që kemi t'ia përcjellim Kuvendit për aq sa referoi edhe zoti Toska. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër?

Alban Toro: Kam kërkuar edhe unë Kryetare!

Naureda Llagami: Ndjesë Alban, se nuk më ka dalë këtu.

Fjala për ty!

Alban Toro: Okej! Faleminderit!

Duket në dy raste ligji sikur përkon me shqetësimin e Brikenës, të paktën neni 43 që i përket edhe procedurës së lëvizjes paralele, por edhe në kastën e juristëve jogjyqtarë të cilët kandidojnë në Gjykatën e Lartë, tek 49/6, ku ligji ka kërkuar përvojën e veçantë në 5 vitet e fundit të personit që kandidon. Pra në këtë rast ligjvënësi ka parashikuar rastin kur ky person duhet të gëzojë një dedikim të veçantë në fushën ku ai kandidon. Por në rastin e 47-ës, pra të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, ligji ka ometuar. Siç thotë edhe parimi i vjetër latin “Verba volant, scripta manent”, në kushtet kur mungon një formë e shkruar nga ligjvënësi, që detyron të merret parasysh përvoja e dedikuar në 5 vitet e fundit, në 10 vitet e fundit, nga ana jonë nuk kemi mundësi tjetër vetëm të zbatojmë ligjin ashtu siç është sepse në fund të fundit detyrimi i organit publik është të zbatojë nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative dhe të ushtrojë kompetencën që ka përcaktuar ligji. Pra nuk mund të dalim të provojmë dhe të interpretojmë ligjin në një formë kur ai nuk e parashikon. Kështu që, e vetmja formë është që ta adresojmë atë atje ku duhet, në Parlament, në mënyrë që të përkojë me qëllimin nëse do të jetë qëllimi i ligjvënësit që edhe në këtë format kandidati të gëzojë një dedikim të caktuar në pozicionin ku ai kandidon.

Kështu që, bashkohem me opinionin e Erjonit dhe Ilirit që, aktualisht nuk kemi çfarë të bëjmë, thjesht duhet ta adresojmë këtë shqetësim kur të çojmë ndryshimet e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Parlament. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë diskutim tjetër?

Maksim Qoku: Unë të them të drejtën, do ta shikoja në këndvështrimin e një vendimmarrjeje të mëparshme ku ne shpallëm vendet e lira, në referim që u bë nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ne arsyetuam se nuk duhen shpallur vendet në të drejtën penale dhe për pasojë bëme shpalljen e fushave të tjera. E nis këtu faktin që më duket sikur nga këto lloj veprimesh tona, e drejta e gjyqtarit për të konkurruar në të gjitha fushat, në vend që të na çojë që tashmë gjyqtarët e specializuar në fushë penale prej kaq vitesh të na shkojnë në pozicione administrative dhe civile dhe nesër, për pozicionet e mbetura penale, të na shkojnë magjistratë të fushës civile dhe administrative. E thashë këtë për faktin që, ne nuk mund të themi që autoriteti i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i pamundur që të jetë rregullator, për sa 147-ta e Kushtetutës ne na jep të drejtën e një organi qeverisës për mbarëvajtjen e sistemit.

Për t'i hyrë konkretisht, unë dua ta shoh ligjin në frymë sepse nuk mund ta mendoj që ligji është gazetë që mund të lexohet dhe duhet të përmendë çdo gjë që ne na duhet ta lexojmë.

Po të shkojmë tej ligji për pushtetin gjyqësor, që në nenin e 15-të, thuhet në paragrafin e katërt, në pikën 4 të këtij neni "...me qëllim rritjen e efikasitetit dhe sigurimit të specializimit në gjykata..." dhe përcaktohet numri i gjyqtarëve, sepse ne duhet të jemi koshient që tashmë gjyqtari, pavarësisht se është i tillë në detyrë, nuk mund të dijë gjithçka dhe nuk mund të jetë i specializuar gjithkund, aq më tepër edhe ndarja në seksione, këtë qëllim ka pasur dhe për më tej edhe neni 21, po i këtij ligji, që thotë që Gjykata e Lartë gjykon në tre seksione, penal, civil dhe administrativ, po përsëri këtë qëllim ka pasur.

Kështu që, dua t'i referohem vetëm diçkaje që e shoh që e nxit nevojën për t'u sqaruar si term sepse ligji thotë, në pikën 4 të nenit 47, qoftë pika 5, kërkohej "x" vite thotë në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë. Si duhet ta marrim ne këtë termin "i përshtatshëm" sepse normalisht nuk mund të themi që mbasi kam gjykuar për kaq vite në një fushë, ndërkohë që në tërë karrierën time kam gjykuar edhe në fusha të tjera dhe e mbart këtë përvojë sepse të gjithë jemi koshient për faktin që e kryejmë një gjë tani më mirë se diçka që e kemi kryer vite më parë. Ne të gjithë jemi

juristë, por kemi marrë drejtimit tona në jetë dhe natyrisht që jemi profilizuar në një drejtim të tillë.

Ne mbajmë një qëndrim shumë të drejtë dhe kontrollues për sa i përket juristëve të spikatur sepse nisur nga termi “i spikatur”, verifikuam kushtet konkrete dhe lidhjet me fushat specifike, duke respektuar edhe kërkimet e kandidatëve edhe prekjen e tyre me fushat përkatëse.

Tani, mua nuk më duket që po shkojmë në frymën e ligjit dhe aq më tepër të nxjerrim edhe veten si të pamundur në lidhje me një gjë që vetë fryma e ligjit e shpreh, që sot po shkohet drejt një profilizimi dhe në shkallë më të larta kërkohen gjithmonë gjyqtarë më të profilizuar. Prandaj do të isha dakord me propozimin e Brikenës, ne mund t’ua kërkojmë një mendim misioneve, sikurse bëjmë edhe për pozicionet, për numrin e pozicioneve dhe nëse një mendim i tyre do të na jepej, do të na bëhej ndihmë pastaj për të arritur ne në një përfundim më të logjikshëm, për faktin që kjo praktikë që do të ndërtojmë, do të mbetet pastaj për të gjithë ngritjet në detyrë në të ardhmen. Faleminderit!

Marçela Shehu: A mundem edhe unë Kryetare të shprehem?

Naureda Llagami: Po, Marçela!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Unë i dëgjova me kujdes të gjithë kolegët dhe në fakt ndaj mendime të ngjashme pothuaj me të thithë nga pak. Pra ka shumë të vërteta dhe logjike në atë që thotë Brikena, sikurse ka shumë të vërteta dhe logjike në atë që thonë anëtarët e tjerë.

Unë si relatores e disa projektvendimeve që janë paraqitur, edhe si anëtare e KZHK-së, vlerësoj, ashtu siç ka vlerësuar edhe Komisioni në verifikimet që ka kryer, se për sa kohë ky kufizim nuk është përcaktuar në ligj, Këshilli nuk ka tagra dhe kompetencat ligjore për të përcaktuar standarde të tilla që dalin tej kuptimit dhe interpretimit të ligjit, tej parashikimit ligjor. Gjithashtu, vlerësoj se nëse do ishte e udhës që ky diskutim të bëheshe, unë bashkohem me Ilirin, që ky diskutim duhet të ishte bërë shumë kohë më përpara, përpara se ne të shpallnim hapjen e procedurës për pozicionet e lira ose mbase edhe atë ditë, por këtë diskutim ne nuk mund ta bëjmë në këtë moment, që

tashmë ne i kemi edhe kandidatët dhe ku rezulton që disa prej tyre vijnë nga një fushë tjetër dhe kandidojnë në një fushë tjetër. Pra ne, nuk mund të vendosim ca rregulla dhe standarde tani që gara dhe konkurrimi është hapur dhe nuk do të ishte e drejtë edhe për ata të cilët kanë aplikuar dhe kanë pritshmëritë e tyre lidhur me kandidimet që ata kanë bërë.

Kështu që, për këto arsye, unë mendoj që ne nuk mund ta vijojmë më tej diskutimin lidhur me këtë moment. Nuk mendoj se ligji ka paqartësi të tilla për t'i kërkuar ne mendim misioneve, si EURALIUS edhe USAID sepse siç e thashë, ligji nuk e ka parashikuar, pra ne nuk mund t'i kërkojmë një mendim se çfarë ka dashur ligjvënësi, çfarë ka pasur në mendje ligjvënësi. Ligji është i qartë. Kështu që, për sa kohë është i qartë, nuk besoj se edhe misionet do të kenë një interpretim ndryshe të ligjit nga ajo që del kur e lexon.

Edhe diçka tjetër, ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorë në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në vitin 2016. Pra, të gjitha këto parashikime, rregulla, si për lëvizjen paralele, si për ngritjen në detyrë, kanë hyrë në fuqi në këtë datë dhe sjellin efekte pas kësaj date. Ka shumë gjyqtarë që para vitit 2016 kanë ushtruar funksionin e tyre si gjyqtar në një fushë të caktuar, për shembull në fushën e së drejtës penale për një periudhë të caktuar. Por ai gjyqtar, deri në këtë moment nuk e dinte që pas këtij momenti ai nuk do të kishte më të drejtë të mendonte për të zhvilluar karrierën e tij në një fushë tjetër nga ajo që ai gjykonte. Pra janë rregulla loje që janë përcaktuar më vonë me ligjin që hyri në fuqi në 2016-ën. Ndaj, bazuar në këtë logjikë, unë shkoj dhe bashkohem me zotin Muharremaj që kjo do të ishte diskriminuese për gjyqtarët dhe do të cenonte parimin e sigurisë juridike. Faleminderit!

Naureda Llagami: Diskutim tjetër?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Unë e thashë edhe në fillim të diskutimit tim që interpretimi që ne i bëjmë nenit 47, pika 5, në fakt nuk shkon me logjikën e mënyrës se si është konceptuar jo vetëm në këtë ligj por edhe në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ndërtimi i karrierës së gjyqtarit. Për sa i përket termave të përdorur në ligj, nëse qëllimi i

ligjvënësit do të ishte që ky 5 vjet përvojë profesionale mund të shtrihej gjatë gjithë përvojës profesionale që mund të kishte gjyqtari, do ta bënte siç kundër e ka bërë tek neni 47, pika 6. Tek neni 47, pika 6, kur bëhet fjalë për magjistratët që ngrihen në detyrë në pozicionin e kryetarit, nuk shprehet “nga të cilat” por shprehet “gjatë së cilës”. Pra, sikundër kolegët argumentojnë që nëse do të ishte për qëllim që të ishin 5 vitet e fundit apo 5 vjet në 13 vitet e fundit, do ta kishte shprehur, sikundër e ka bërë në dispozitat e mëparshme, edhe në këtë rast, nëse e ka pasur për qëllim që këto 5 vjet mund të shtrihen në gjithë përvojën profesionale të gjyqtarit, do ta kishte shprehur siç e ka bërë tek pika 6 e nenit 47. Prandaj, në vlerësimin tim, 5 vjet në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme, minimalisht duhet të shihen brenda 13-vjetëshit, nëse nuk do të arrijmë në konkluzionin që këto duhet të jenë 5 vitet e fundit.

Meqenëse shumica e kolegëve mendojnë që nuk është e nevojshme që të marrim një mendim të specializuar, në vlerësimin tim, duhet ta marrim sepse nëse nuk e marrim për këtë rast, nuk e di për çfarë rasti tjetër mund ta marrim; për të gjithë elementët mbi të cilët ne kemi vendosur për karrierën e gjyqtarit, duke bërë fjalë edhe për pozicionet, siç e përmendi zoti Qoku, i morëm mendim misioneve mbështetëse; vlerësoj që edhe një herë t’iu kërkohet mendim lidhur me mënyrën se si duhet të interpretohet dhe të vlerësohet nga ne përvoja profesionale specifike 5-vjeçare në gjithë kohëzgjatjen e përvojës profesionale të gjyqtarit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi një propozim nga zonja Ukperaj e cila kërkon që, për çështjen në fjalë, t’i kërkohet një mendim të specializuar misioneve. Do ta hedhim fillimisht në votim këtë çështje dhe më pas kalojmë sipas rendit të ditës.

Atëherë, edhe një herë, hedhim në votim propozimin, meqë kemi një propozim konkret nga zonja Ukperaj, lidhur me çështjen dhe interpretimet që ajo mendon që asistenca e projekteve mund të na ndihmojë edhe pse do donim që të vepronim sa më shpejt në fakt me këto procese.

Atëherë, hedhim në votim propozimin.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër, me arsyetimin që së pari, që për mua është i qartë interpretimi i ligjit dhe së dyti, atë që theksoi edhe në fund zonja Shehu, që u tha edhe

nga zoti Toska, ne nuk mund të vëmë rregulla loje mbas lojës, kjo duhet bërë përpara se të vinin kandidatët sepse ajo që lexohet keq është që ne pritëm kandidatët dhe tani po vëmë kriteret e skualifikimit dhe kualifikimit. Kështu që për mua, absolutisht kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro. Në vijim të qëndrimeve të mëparshme, për të kërkuar prej partnerëve tanë ndërkombëtarë edhe mendimin e tyre për çështje të caktuara.

Brikena Ukperaj: Pro, edhe me arsyetimin që është mirë që një gjë ta bëjmë mirë, pavarësisht se mund të jemi edhe me vonesë.

Medi Bici: Pro, me arsyetimin e Brikenës dhe të Erjonit.

Naureda Llagami: Në fakt edhe unë jam dakord që asistenca e partnerëve duhet të na udhëheqë në situata të tilla kur ne kemi këto lloj diskutimesh. Për sa kohë që shumica vendosi që nuk kemi nevojë që të marrim mendim nga partnerët, kalojmë, vazhdojmë me rendin e ditës, duke ia dhënë fjalën zotit Toska në çështjen e parë.

Ilir Toska: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, çështja e parë ka të bëjë me projektvendimin që paraqitet sa i përket verifikimit të plotësimin të katër kriterëve formale në lidhje me kandidatin z. {...}, që ka konkurruar për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Siç jeni në dijeni, KLGJ më datë 26 shkurt 2020 ka hapur disa procedura të ngritjes në detyrë, ndër to edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 93, datë 26.02.2020 ka kandiduar edhe zoti {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Ndërkohë, referuar akteve rregullatore, Këshilli me vendimin nr. 153, datë 06.05.2020 ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.93, ku në këtë rast, pas shortit të hedhur, si relator për kryerjen e verifikimit për kandidatin {...}, jam caktuar unë.

Referuar rregullave sipas Rregullores së miratuar nga Këshilli për të këtë qëllim më datë 07.05.2020, ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve të kandidimit për zotën {...}. Është bërë njoftimi për relatorin dhe e drejta që kishte kandidati për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të çdo anëtarit të Këshillit. I është kërkuar të plotësojë dokumentacionin në lidhje me kandidimin. Kandidati nuk ka pasur pretendime për relatorin apo për ndonjë anëtar të Këshillit, ndërkohë që ka depozituar rregullisht edhe dokumentacionin e nevojshëm për të vlerësuar kriteret e kandidimit për të.

Sa i përket kriterit të “verifikimit të pasurisë dhe figurës”, ndërsa zoti {...} është subjekt rivlerësimi kalimtar, sipas ligjit 84/2016, ndërkohë që edhe ligji për Statusin kërkon që gjyqtarët në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund të emërohen vetëm pasi të kenë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, i është kërkuar KPK-së trajtimi me përparësi të procedurës së vlerësimit kalimtar për zotën Çela, gjë e cila është marrë në konsideratë nga KPK-ja dhe ka njoftuar për të me shkresën e datës 26 maj 2020. Nga ana tjetër, referuar edhe vendimit me të cilin është shpallur pozicioni i lirë, pra vendimit nr. 93, datë 26 shkurt 2020, procedura e verifikimit të kriterëve ka vijuar për katër kriteret formale të kandidimit, ndërkohë që e gjithë procedura e verifikimit do të mbyllet mbasi të vijë përgjigjja nga organet e rivlerësimit, sa i përket kriterit të pasurisë dhe të figurës.

Këshilli ka konsideruar që të vijojë procedurat për verifikimin e kriterëve të tjera, me qëllim që procedura e ngritjes në detyrë të ecë sa më shpejt, pra krahas procesit të verifikimit të kriterëve të kandidimit, të vijojë edhe procesi i vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin, për të cilin do të verifikohet plotësimi i katër kriterëve formale që kërkon ligji, pra me përjashtim të kriterit të pasurisë dhe të figurës, që do të eci paralelisht me procesin e vlerësimit etik dhe profesional.

Sa i përket katër kriterëve formale që kërkon ligji dhe që ne kemi konsideruar në vendimin nr. 93 të datës 26 shkurt 2020, është ai i “përvojës profesionale minimale”. Në lidhje me këtë kriter është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, po kështu është marrë

informacion sa i përket përvojës specifike nga gjykatat ku zoti {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Sa i përket “përvojës profesionale minimale” që kërkohet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjen reflektim në shkronjën “a” të pikës 5 të vendimit të Këshillit nr. 93, datë 26.02.2020, ndërkohë që përcaktohet si kriter kandidimi në nenin 47/2/a të ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbajt parasysh se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike, pra jo më pak se 5 vjet në fushën e drejtës përkatëse të përshtatshme.

Në lidhje me “përvojën e përgjithshme profesionale”, në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Në periudhën 10.11.2011 - 22.01.2014, ai ka kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ndërkohë që ka marrë këtë emërim provizor të përkohshëm me Dekretin nr. 7155, datë 10.11.2011, të Presidentit të Republikës. Ndërkohë, ka marrë emërimin përfundimtar me Dekretin nr. 8467, datë 23.01.2014, ku është emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Në vijim, sipas jetëshkrimit të kandidatit, në periudhën 13.06.2018 - 12.03.2019, bazuar në vendimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 47, datë 13.06.2018, ai është transferuar përkohësisht pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Më pas, pra mbas datës 12.03.2019 kur është ndërprerë transferimi i përkohshëm në KLGJ, ka vijuar detyrën përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, ku vijon edhe sot.

Të njëjtat të dhëna që përshkruhen në jetëshkrimin e bërë nga kandidati, konfirmohen edhe nga dokumentacioni që ndodhet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

Nga të dhënat rezultojnë se kandidati {...} rezultojnë të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me “përvojën specifike profesionale” është marrë informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Sipas këtij informacioni gjyqtari {...} me Dekretin e datës 10.11.2011 të Presidentit të Republikës, është caktuar për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec nga data 10.11.2011 deri 23.01.2014.

Për këtë periudhë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka funksionuar e ndarë në seksione, por ka funksionuar me trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale.

Bashkëlidhur janë vënë në dispozicion edhe urdhrat e kryetarit të gjykatës për formimin e trupave gjykues dhe përbërjen e tyre me tre gjyqtarë.

Pavarësisht përgjigjes së dhënë në mënyrë të përgjithshme nga kjo gjykatë, referuar listës bashkëngjitur asaj, ku pasqyrohen të dhëna për çështjet penale që ka gjykuar ky gjyqtar, rezultojnë se ai është shortuar për të gjykuar çështje të kësaj natyre për periudhën shkurt 2012 - dhjetor 2012, e duke dhënë vendime për këto çështje deri në fillim të janarit 2013. Pra, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec kandidati ka gjykuar çështje penale për një periudhë 1-vjeçare.

Sa i përket informacionit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, rezultojnë se: “Zoti {...}, me vendimin nr. 47, datë 13.06.2018, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata”, është transferuar përkohësisht për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Ky transferim i përkohshëm ka përfunduar në datën 12.03.2019, pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin e tij nr. 46, datë 12.03.2019 ka vendosur deklarinimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm dhe kthimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Gjatë kësaj periudhe kur gjyqtari {...} ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ai ka gjykuar si çështje penale ashtu edhe çështje civile, kjo për faktin se Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Kukës për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve që ka në organikën e saj (4 gjyqtarë) e ka të pamundur që zhvillimin e veprimtarisë gjyqësore ta kryejë me ndarje në seksione të veçanta. Pra, të gjithë gjyqtarët pjesë e organikës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës marrin pjesë në shortimin elektronik të çështjeve gjyqësore duke marrë për gjykim si çështje civile ashtu edhe çështje penale. Nga verifikimi i kryer nga ana e specialistit të IT-së, në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIC i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, rezulton se përgjatë periudhës kohore nga data 13.06.2018 deri në datën 12.03.2019, gjyqtari {...} ka gjykuar çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate si më poshtë: çështje penale -129; çështje civile - 162...”.

Në vijim, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, rezulton se: “...në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk kemi ndarje në dhoma/seksione të gjyqtarëve si shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve”.

Bashkëlidhur shkresës është dërguar edhe një kopje e vendimit nr. 24, datë 23.07.2019 të Këshillit të Gjykatës “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”. Gjithashtu, bashkëlidhur është dërguar edhe evidenca statistikore e ngarkesës së çështjeve të gjykuara nga gjyqtari {...}, për periudhën 01.01.2014 - 31.12.2019 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z.{...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar edhe kriteri i “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Rezulton që kandidati, në respektim të ligjit që përcaktohet në nenin 47, pika 3 të ligjit për Statusin, ka plotësuar formularët e vetëdeklarimit sipas Shtojcës B “Deklarata 1” për veten e vet po edhe për të afërmit e tij që është bashkëshortja, ka plotësuar edhe formularin përkatës.

Sa më sipër rezulton se kandidati dhe familjarët e tij, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve

përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Në vijim për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Ky kriter gjen përcaktim në nenin 48, pika 8 të Ligjit për Statusin ku thuhet se: “Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Për këtë kriter kandidimi është marrë informacion, përveç vetëdeklarimit të gjyqtarit në momentin e kandidimit, ku ai shprehet se nuk ka masë disiplinore në fuqi, është marrë informacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku referuar të cilit rezulton se kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Më tej për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, që përcaktohet në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin. Për këtë është marrë vetëdeklarimi në momentin e kandidimit nga ana e kandidatit, ku është shprehur se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale nëse ngrihet në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërkohë që, gjatë verifikimit, nuk rezulton ndonjë e dhënë tjetër e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Materiali i përgatitur nga unë si relator, paraprakisht u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 12 qershor 2020 konsideroi të plotë verifikimin dhe procedurën e ndjekur për sa i përket katër kritereve formale të kandidimit të z. {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 93 dhe në këtë rast Komisioni vendosi që çështja t’i përcillet për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili do duhet të vendosë për verifikimin e plotësimit ose jo nga kandidati z. {...} të katër kritereve formale të sipërpërmendura.

Në këtë rast, unë si relator i çështjes, kam përgatitur edhe projektvendimin përkatës, sipas të cilit Këshillit i propozoj që të vendosë verifikimin e plotësimit nga

kandidati z. {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 93, datë 26.02.2020 të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur sipas vendimit nr. 93, datë 26.02.2020. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Projekt-akti miratohet sipas propozimit të bërë nga relatori dhe nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Projekt-akt që do të relatohet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për kandidimin e zonjës {...} është përgatitur nga ana ime si relator i çështjes relacioni përkatës sa i përket të dhënave në lidhje me verifikimin e katër kritereve formale të kandidimit për pozicionin që ka kandiduar {...} në procedurat e ngritjes në

detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Relacionin e keni marrë paraprakisht krahas edhe një projektvendimi që unë e kam propozuar si relator për këtë rast.

Sjell në vëmendjen tuaj se zonja {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira që Këshilli ka shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 26 shkurt 2020, konkretisht për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90.

Sa i përket katër kriterëve formale, ndërkohë që për kriterin e “pasurisë së figurës” procedura e verifikimit vijon, referuar pikës 9 të vendimeve të sipërpërmendura që i përket shpalljes së pozicioneve të lira, ka përfunduar verifikimi për katër kriteret formale të kandidimit për zonjën {...}, me qëllim që Këshilli të mund të vijojë paralelisht me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatës.

Sa i përket “përvojës profesionale minimale” që kërkohet nga ligji, mund t’ju them që kjo përvojë përcaktohet në nenin 47 të ligjit për Statusin, sipas dispozitës përkatëse në këtë nen “Për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Lidhur me përvojën e përgjithshme rezulton që kandidatja zonja {...} të ketë mbi 10 vjet përvojë të përgjithshme profesionale referuar këtyre fakteve: rezulton se zonjë {...} të ketë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2002. Ajo ka kryer stazhin profesional për një periudhë 9-mujore, nga data 01.10.2001, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, me përfundimin e stazhit profesional ka marrë edhe emërimin përfundimtar me Dekret të Presidentit të Republikës dhe me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është emëruar po në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vijuar të ushtrojë detyrën deri më datë 14 korrik 2015, datë kur është emëruar pranë Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ku vijon edhe sot tashmë nën emërtimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Referuar kësaj përvoje, rezulton që

zonja {...} të ketë mbi 10 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Sa i përket “përvojës specifike profesionale” është marrë informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa përvoja specifike në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda (prej datës 14 korrik 2015) është e qartë sepse është në fushën e të drejtës penale, pra informacioni i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i është dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku rezulton se zonja {...} ka ushtruar veprimtarinë e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën 08.10.2001 deri 14.07.2015. Sipas dokumentacionit që disponohet pranë kësaj gjykate, rezulton se ajo ka qenë e caktuar si gjyqtare në dhomën/seksionin penal për periudhat: 10.05.2005 - 06.01.2008 dhe 21.01.2009 - 17.01.2011. Nisur nga kjo, periudha e përvojës specifike në fushën e të drejtës penale, duke i shtuar edhe përvojën specifike në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, aktualisht për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, plotëson përvojën minimale 5-vjeçare që kërkohet për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për zonjën {...} është verifikuar edhe kriteri i “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Në fakt, këtë pëlqim, {...} dhe familjarët e afërt të saj e kanë dhënë që në momentin që Këshilli i Latë Gjyqësor ka vendosur caktimin e përkohshëm të zonjës {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në momentin që ka filluar funksionimin kjo gjykatë, pra që në datën 18.12.2019.

Gjithsesi, zonja {...}, në momentin e kandidimit, ka dorëzuar përsëri formularët tip të plotësuar nga vet ajo dhe bashkëshorti i saj si familjar i afërt.

Për zonjën {...} është verifikuar edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Një gjë e tillë është vetëdeklaruar nga zonja {...} sipas formularit tip në momentin e kandidimit, po kështu është marrë një informacion i tillë edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, nga rezulton se znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Së fundi, për kandidaten znj. {...} është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Për këtë kandidatja ka plotësuar formularin tip në momentin e deklarimit. Ndërkohë që, gjatë momentit të verifikimit nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo që ka deklaruar vet kandidatja, në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Edhe në këtë rast, verifikimi i katër kriterëve formale si më lart të përmendur, është shqyrtuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës më datë 12 qershor 2020. Komisioni e ka konsideruar të plotë procedurën dhe verifikimin e këtyre katër kriterëve formale dhe ka vendosur që çështja t’i kalojë Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ai për verifikimit e plotësimin ose jo nga zonja {...} të katër kriterëve formale.

Nga ana tjetër, unë me cilësinë e relatorit të çështjes, referuar të dhënave të rezultuara gjatë verifikimit, kam përgatitur projektvendimin, nëpërmjet të cilit i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska, për relatimin e projekt-aktit!

Ndonjë diskutim lidhur me relatimin?

Atëherë, nëse jo, kalojmë në votim sipas Rregullores duke filluar nga relatori, Komisioni dhe më pas anëtarët.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 90 dhe nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër i radhës, relatore për të cilin është zonja Shehu. Ky projekt-akt ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për më shumë detaje, ia jap fjalën relatores.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Përpara se të filloj relatimin, nëse anëtarët do të ishin dakord që unë të bëja një përmbledhje të shkurtër, duke qenë se relacionet u janë shpërndarë anëtarëve dhe i disponojnë.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Kandidatja {...} ka kandiduar për tre pozicione të shpallura për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht për pozicionet 88, 90 dhe 91 të shpallura më datë 26.02.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pas hedhjes së shortit, unë jam caktuar me cilësinë e relatores për të realizuar verifikimin e përmbushjes së kushteve formale që lidhen me kandidimin e zonjës {...}.

Nga verifikimet ka rezultuar se zonja {...} përmbush të katër kriteret që kërkon neni 47 i ligjit për Statusin dhe konkretisht zonja {...} përmbush kushtin “përvojës profesionale të përgjithshme” si gjyqtare, pasi ajo rezulton që ka mbi 10 vjet si gjyqtare.

Përmbush gjithashtu kushtin e “përvojës profesionale specifike”, pasi rezulton se ka mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës penale.

Zonja {...} gjithashtu përmbush edhe kriterin e “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, pasi ajo dhe familjarët e saj kanë dhënë pëlqimet dhe autorizimet përkatëse, ashtu siç i kërkon ligji.

Rezulton gjithashtu se zonja {...} plotëson edhe kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, pasi rezulton nga informacioni që është marrë edhe është administruar nga raportja dhe nga Komisioni, që ndaj zonjës {...} nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu zonja {...} plotëson edhe kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”. Nuk rezulton që zonja {...} të ketë probleme lidhur me këtë kriter që vendos ligji.

Në këto kushte, unë si relatores, bashkë me miratimin edhe të Komisionit, kemi përgatitur një projektvendim ku i kërkohet Këshillit të Lartë Gjyqësor që të disponojë lidhur me 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të kritereve që kërkon ligji dhe konkretisht të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Ky është edhe propozimi që bën relatorja lidhur me këtë kandidatë.

Duke qenë se votimi fillon nga unë dhe Komisioni, unë votoj pro.

Marçela Shehu: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të përcjellë nga Komisioni.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit të këtij projekt-akti, zotit Alban Toro.

Alban Toro: Më herët, me vendimin nr. 88, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, Këshilli procedoi me hapjen e pozicionit të lirë dhe më pas, për shkak të problemit që ka shkaktuar përhapja e COVID-it, me një vendimmarrje të veçantë, ka shtyrë afatin e kandidimit deri më datë 27.05.2020. Paraprakisht, me vendimin nr. 152, 06.05.2020 është filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërkohë që është caktuar si relator Alban Toro për kandidaten {...}, e cila më pas është ftuar të depozitojë aktet e nevojshme të cilat do të provonin plotësimin e kriterëve formale nga ana e saj.

Nga ana e kandidatës janë paraqitur të gjitha aktet e nevojshme për plotësimin që dokumentojnë dhe provojnë verifikimin e kriterëve të kërkuara nga ligji, të cilat do t'i rendis më poshtë.

Në lidhje me “përvojën profesionale”, në përputhje me ligjin, pra neni 47, pika 5, për këtë pozicion, magistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për verifikimin e kandidatës në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë është mbajtur parasysh se kandidatja, krahas përvojes së përgjithshme profesionale minimale, pra jo më pak se dhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë.

Nga aktet që disponohet konfirmohet se ajo ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2001-2004. Ka kryer stazhin profesional, nga data 21.10.2003 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhe më pas është emëruar gjyqtare, po në këtë gjykatë, ku ka gjykuar në seksionet penale, civile deri në datën 14.07.2015. Më pas nga data 14.07.2015 deri më datë 23.01.2020 është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe nga data 23.01.2020, kur fillon funksionimin Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pranë kësaj gjykate, ku vijon të ushtrojë funksionin e gjyqtares.

Nga aktet që ka përcjellë Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka filluar detyrën me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 3983, datë 21.10.2003 ku është emëruar për të kryer stazhin profesional, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe me Dekret të Presidentit të

Republikës nr. 4313, datë 16.09.2004, është emëruar definitivisht gjyqtare po pranë kësaj gjykate. Më pas me Dekretin nr. 9176, datë 14.07.2015 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Aktualisht me vendimin nr. 39, datë 23.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar në mënyrë të përhershme pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, rezulton të ketë mbi 10 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me “përvojën specifike profesionale”, në kërkesat për shprehje interesi të kandidates, evidentohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për periudhën 2003-2014, ajo ka gjykuar çështje të karakterit penal dhe civil.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë administruar informacionet përkatëse të cilat ju i dispononi nëpërmjet relacionit dhe rezulton që ajo të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale.

Gjithashtu për zonjën {...} është verifikuar edhe kriteri i “dhënies së pëlqimit. Është administruar dokumentacioni përkatës ku është shprehur ky pëlqim nga ajo dhe nga familjarët e saj në lidhje me kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 dhe në këtë kuadër ajo plotëson edhe këtë kriter.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk rezulton që nga ana e kandidates të ketë masë disiplinore në fuqi, si dhe, po nga ky dokumentacion nuk rezulton që nga ana e {...} nuk rezulton të ndodhet në një situatë papajtueshmëri ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kështu që, në këto kushte, relatori e kaloi çështjen në Komision, i cili në mbledhjen e datës 15.06.2020, ka vendosur kalimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për ta vlerësuar, duke përgatitur edhe draftin përkatës të projektvendimit, i cili parashikon: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr.95/2016, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”; Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit 115/2016. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nga kolegët nuk ka ndonjë diskutim, nisim procesin e votimit duke filluar nga relatori, Komisioni dhe më pas anëtarët e Këshillit.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit për kandidatin z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”, projekt-akti i cili është përgatitur dhe do relatohet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, zonja Kryetare!

Kandidati, gjyqtari {...} ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. Pas aplikimit nga kandidati, në cilësinë e relatores, bazuar në shortin që është hedhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është realizuar verifikimi

nga ana ime i tre kritereve formale që përcakton ligji lidhur me kandidimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, konkretisht, lidhur me “përvojën profesionale specifike”, me “mospasjen e masës disiplinore në fuqi” dhe “mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Nga verifikimet ka rezultuar se z. {...}, gjyqtari plotëson të treja këto kritere. Ai plotëson kriterin e “përvojës profesionale” si atë të përgjithshme ashtu edhe specifike, pasi rezulton të ketë mbi 13 vjet gjyqtar në një gjykatë më të ulët (në gjykatën e shkallës së parë), rezulton gjithashtu që kandidati plotëson edhe kriterin e përvojës specifike, pasi rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile.

Nga verifikimi, ka rezultuar gjithashtu që kandidati plotëson edhe kriterin e dytë që kërkon ligji, konkretisht atë të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Nga verifikimi që është kryer nga dokumentacioni që rezulton për zotën {...}, nuk rezulton që ai të ketë marrë ndonjëherë masë disiplinore apo të ketë ndonjë masë të tillë në fuqi.

Gjithashtu rezulton se zoti {...} nuk ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale, duke përmbushur kështu edhe kriterin e tretë formal, atë të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Bazuar si më sipër, pas verifikimit dhe shqyrtimit që ka bërë edhe Komisioni pas relatimit të çështjes në Komision, unë me cilësinë e relatores i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor miratimin e projektvendimit të hartuar, ku në pikën 1 i kërkohet që Këshilli të vendosë 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati, në procedurat e ngritjes në detyrë, për dy pozicione atë me nr. 85 dhe nr. 86, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit.

Ky është relacioni dhe projektvendimi i përgatitur.

Unë në cilësinë e relatores jam dakord me miratimin e tij.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk kemi diskutime...

Po! Ka Brikena diçka.

Brikena Ukperaj: E kam parë relacionin dhe nuk e di Marçela nëse jam korrekte, zoti {...} ka përvojë profesionale specifike 5 vjet e 2 muaj para vitit 2005?

Marçela Shehu: Ja, një sekondë!

Brikena Ukperaj: Është emëruar më 15.09.2000.

Marçela Shehu: Atëherë, më 15.09.2000 ai është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin nr. 3111, datë 02.10.2001, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Brikena Ukperaj: Domethënë, përvoja specifike është 5 vjet e 2 muaj dhe kjo është para vitit 2005.

Marçela Shehu: Po, po!

Brikena Ukperaj: Okej! Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në procedurën e votimit?

(Zonja Shehu, në cilësinë e relatores votoi pro projektvendimit në përfundim të relatimit të relacionit.)

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Kundër, me arsyetimin që bazuar në pikën 5 të nenit 47, kandidati nuk mbart përvojën në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin për të cilin aplikon. Duke nisur nga përvoja e tij e gjatë në fushën penale, do desha që kandidimi i tij, për aq vlera sa ka edhe personalisht e njoh, të kandidonte si një element i spikatur në fushën penale. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, me logjikën e arsytimit që ndoqa edhe më parë. Në vlerësimin tim, 5 vitet e përvojës profesionale duhet të jenë 13 vitet e fundit. Zoti {...} ka që në vitin 2005, pra ka më shumë se 15 vite që është gjyqtar i një gjykate të posaçme, është Gjykata e Shkallës së Parë (sot aktuale) për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Krimeve të Rënda) dhe gjithë përvojën profesionale 5 vjet e 2 muaj e ka

para periudhës 13-vjeçare. Në këto kushte, unë besoj që nuk plotëson kriterin e kërkuar për pozicionin e fushës së përshtatshme, prandaj votoj kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, projekt-akti u miratua sipas propozimit të bërë nga KZHK.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga relatore Marçela Shehu (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, për të cilën fjalën e ka përsëri Marçela.

Marçela Shehu: Kandidati, z. {...} ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës administrative, pozicione këto të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020. Edhe për kandidatin z. {...} është realizuar e njëjta procedurë verifikimi të kritereve formale lidhur me kandidimin e tij në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi i kryer, ka rezultuar se zoti {...} i plotëson të treja kriteret formale për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Rezulton se zoti {...} ka mbi 13 vjet gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë në Gjykatën

Administrative të Shkallës së Parë. Rezulton gjithashtu që zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi dh nuk ka probleme me kriterin e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte është hartuar projektvendimi përkatës, ku i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidati të treja kritereve formale që përcakton ligji dhe vijimin e procedurës së verifikimit të mëtejshëm lidhur me këtë kandidat. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim përpara se të fillojmë procesin e votimit?

Nëse jo, atëherë fillojmë procesin e votimit, nga relatorja, më pas anëtarët e Komisionit dhe më pas anëtarët e Këshillit.

Marçela Shehu: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, projekt-akt i cili është përgatitur nga relatori, z. Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, me dy vendime të veçanta, nga ana e Këshillit, me nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020 është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Gjithashtu, po me vendim të veçantë, për shkak të problemeve që ka shkaktuar përhapja e COVID-it,

afati i kandidimit është shtyrë deri më datë 26.05.2020. Brenda këtij afati ka kandiduar dhe gjyqtarja zonja {...}, për të cilën, me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020 jam caktuar edhe relator.

Brenda kompetencave të parashikuara edhe nga aktet rregullative të KLGJ-së është ftuar kandidatja që të depozitohet aktet e nevojshme për plotësimin e kriterëve formale të caktuara nga ligji, e cila, në këtë kuadër, ka depozituar provat përkatëse, nga të cilat rezulton se, në përputhje me nenin 47, pika 5 e ligjit, e cila kërkon që “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”, pra magjistratja ka depozituar aktet të cilat do të provonin këtë përvojë profesionale. Gjithashtu janë kërkuar edhe akte të tjera nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, nga i cili rezulton se me Dekretin nr.2742, datë 15.09.2000 është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas me Dekret nr.3111, datë 02.10.2001 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Më pas me Dekretin nr. 4793, datë 28.02.2006 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. Me Vendim të KLD-së nr. 276, datë 06.05.2011 kandidatja ka ushtruar funksionin e pedagoges së brendshme në Shkollën e Magjistrature, deri kur me Vendim nr. 56, datë 28.05.2014 është rikthyer në pozicionin e mëparshëm pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Së fundmi me Vendimin nr. 287, datë 18.12.2019 të KLGJ është emëruar në mënyrë të përhershme pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Pra nga këto akte rezulton që të ketë mbi 19 vjet përvojë si gjyqtare në shkallën parë dhe në shkallën e dytë.

Në lidhje me “përvojën specifike”, aktualisht në aktet që ne dispononim kemi konstatuar probleme të cilat na çuan në konkluzionin se kishte më pak se 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, dhe në këtë kuadër i kërkuam kandidates, në formën e gjetjes, të jepte shpjegime të hollësishme në lidhje me pasjen e këtij kriteri dhe me anë të një shkrese të veçantë dhe me provat përkatëse që i bashkëngjiti kësaj shkrese, ka dhënë këto shpjegime:

“Për sa më është kërkuar të shpreh qëndrim në lidhje me ushtrimin e funksionit në fushën e të drejtës civile, parashtroj sa më poshtë: Në përfundim të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës nga shtatori i vitit 2000, kam ushtruar funksionin e gjyqtares, fillimisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e me pas jam emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pranë së cilës kam ushtruar funksionin deri në mars të vitit 2006. Nga ana juaj në verifikim të plotësimit të kushteve formale nga ana ime, është kërkuar informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga arshiva e të cilës ju janë përcjellë disa nga urdhrat e kryetarit të gjykatës për ndarjen e gjyqtareve, në dhomën civile dhe në dhomën penale. Ritheksoj se, nga tetori i vitit 2001, kur jam emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kam ushtruar funksionin si pjesë e dhomës civile, të paktën deri në shtator të vitit 2005 - kur plotësohet afati minimal i kërkuar nga ligji nr. 96/2016. Sa më sipër, gjyqtarët e seksioneve për gjykime të posaçme, ndër të cilët edhe seksioni administrativ, kanë qenë pjesë e dhomës civile. Fakti që në urdhrin e kryetarit të gjykatës për vitin 2004, unë jam caktuar si pjesë e seksionit administrativ, nuk do të thotë që unë nuk kam vijuar të gjykoj edhe çështje civile, të cilat në raport me çështjet e natyrës administrative kanë qenë dukshëm më të shumta. Gjyqtarët e seksionit administrativ, përveçse se kanë marrë për gjykim çështje të natyrës administrative, në mënyrë të vazhdueshme kanë marrë për shqyrtim edhe çështje të natyrës civile (si pjesë e dhomës civile). Sa më sipër, gjatë periudhës që kam ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke filluar që nga tetori i vitit 2001 e në vazhdim, edhe në periudhat që kam qenë pjesë e seksionit administrativ, kam gjykuar në mënyrë të vazhdueshme çështje të natyrës civile. Kjo është lehtësisht e verifikuar përmes llojit të objektit të padive dhe të kërkesave që kam pasur në shqyrtim gjatë kësaj periudhe. Në mbështetje të sa më lart, kam kërkuar informacion zyrtar pranë kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për periudhën nga tetori i vitit 2001 deri në maj të vitit 2002, si dhe për vitin 2004, në lidhje me llojin e çështjeve të gjykuara nga ana ime. Në mungesë të statistikave dhe të urdhrave të kryetarit të gjykatës për ndarjen në dhoma civile e penale për vitin 2001 dhe vitin 2005, për të mbështetur pohimin tim, po ju përcjell përgjigjen që më është kthyer, ku evidentohen lloji i çështjeve që kam gjykuar. Ndërkohë, në lidhje me natyrën e çështjeve që kam gjykuar gjatë vitit 2005, mund ti referoheni vlerësimit tim profesional për periudhën 2005 - 2006, ku janë

evidentuar statistikat në lidhje me çështjet e gjykuara nga ana ime, ku dukshëm përvëlojnë çështjet civile”.

Sipas komunikimit elektronik të kandidatës me kancelarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan më datë 01.06.2020 nga zyra e arkivës dhe në librat dhe regjistrat e gjykatës janë nxjerr këto të dhëna: për vitin 2001- çështje civile themeli 28 gjykime, çështje administrative/civile 10 gjykime; për vitin 2002- çështje civile themeli 164 gjykime, çështje administrative/civile 32 gjykime; për vitin 2003- çështje civile themeli 133 gjykime, çështje administrative/civile 31 gjykime, çështje administrative/penale 31 gjykime; për vitin 2004 - çështje civile themeli 183 gjykime, çështje administrative/civile 42 gjykime; për vitin 2005 - çështje civile themeli 99 gjykime, çështje administrative/civile 60 gjykime.

“... Në këto rrethana, vlerësoj se plotësohet kriteri i përcaktuar në nenin 47/5 të ligjit nr.96/2016, sipas të cilit magjistrati duhet të ketë të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, në rastin konkret në fushën e të drejtës civile. Në vlerësimin tim, kam më shumë se pesë vjet që gjykoj çështje të fushës së drejtës civile, fakt ky që me ka nxitur të shpreh interesin për të kandiduar si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, në fushën e të drejtës civile.”

Në kuadër të kryerjes së procedurës të verifikimit, relatori i drejtohet kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duke i kërkuar konfirmimin e të dhënave të sipërcituara. Ky i fundit më datë 15.06.2020 ri konfirmon komunikimin e bërë me kandidatet znj. {...} duke na ridërguar edhe njëherë të dhënat e përshkruara më lart.

Në përfundim të analizës së të dhënave të përshkruara më lart, rezulton se kandidatja i ka 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile.

Më pas janë verifikuar kriteret e tjera, si ai i “mospasjes masë disiplinore”, pra nuk rezulton të ketë masë disiplinore në ngarkim të kandidatës.

Gjithashtu, nga informacioni i administruar, nuk ka shkaqe të papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë të zonjës {...}.

Në përfundim, relatori ia dërgon për shqyrtim Komisionit, i cili në mbledhjen e datës 15.06.2020, vendosi t’ia kalojë mbledhjes plenare të KLGJ-së, duke bashkëlidhur edhe propozimin përkatës, ku në dispozitiv ju mund të gjeni: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy

pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85, nr.86, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”; Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85, nr.86 datë 26.02.2020.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse kolegët nuk kanë ndonjë diskutim, unë propozoj të kalojmë në votimin e projekt-aktit, duke filluar nga relatori, anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe më pas anëtarët e Këshillit.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Kundër, me të njëjtin arsyetim. Është një periudhë specifike që nuk është e përshtatshme për pozicionin.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, me të njëjtin arsyetim si edhe më parë. Rezulton që zonja {...} ka që prej vitit 2006 deri më sot që ushtron detyrën në Gjykatën e Posaçme të Apelit, sot për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe përvojën specifike e ka para 13 viteve. Për këtë arsye votoj kundër.

Medi Bici: Pro sepse zonja Albana, nga viti 2006 e deri sot, ka gjykuar me dhjetëra çështje civile dhe administrative.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit të bërë nga relatori, zoti Alban Toro.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me verifikimin dhe plotësimin nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Edhe ky projektvendim është përgatitur nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Me vendimin nr. 85, nr. 86, datë 26.02.2020 Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile. Në këto pozicione ka kandiduar edhe gjyqtarja {...}, për të cilën unë jam caktuar relator.

Në kuadër të procedurës së përcaktuar nga KLGJ-ja është ftuar kandidatja të depozitojë aktet e nevojshme të cilat do të provonin edhe plotësimin e kritereve të

parashikuara nga ligji dhe më pas është kaluar në verifikimin e tyre. Nga ky verifikim ka rezultuar se nga ana e kandidatës plotësohet kriteri i “përvojës profesionale minimale” si edhe kriteri i “përvojës së përgjithshme profesionale” mbi 15 vjet të përcaktuar nga ligji.

Gjithashtu u verifikua pasja e ndonjë mase disiplinore për të cilën në përfundim rezulton që nuk ka një të tillë dhe që mund të skualifikonte kandidaten nga ky konkurrim.

Gjithashtu, është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Edhe nga ky verifikim nuk kanë rezultuar efekte negative për konkurrimin e kandidatës. Kështu që, në përfundim, në datën 15.06.2020, relatori ia kalon Komisionit, i cili vendosi t’ia kalojë për shqyrtim Këshillit, së bashku me propozimin: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk ka ndonjë diskutim, kalojmë në votim sipas procedurës, relator, Komisioni përkatës dhe më pas anëtarët.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të përcjellë nga relatori.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relator Alban Toro (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Ky projekt-akt është përgatitur dhe do relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, më herët, me vendimin nr. 82, nr. 83 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është proceduar me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative,

ndërkohë që me vendimin nr. 86, 26.02.2020 Këshilli ka vendosur dhe hapjen e një pozicioni të lirë në fushën e së drejtës civile. Për të tre këto pozicione, kandidatja {...} ka konkurruar dhe në bazë të vendimit 151, 06.05.2020 jam caktuar relator dhe në përputhje me aktet rregullative të KLGJ-së kam ftuar kandidaten të depozitojë aktet e nevojshme të cilat do të dokumentonin plotësimin e kriterëve ligjore dhe nga ana tjetër, të gjitha këto akte janë verifikuar nëpërmjet dokumentacionit që disponohet në KLGJ.

Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale”. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë gjen reflektim në shkronjën “a” të pikës 5 të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, ku është parashikuar si kush kandidimi në nenin 136, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet që të kërkohen 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, ndërkohë që “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin neni 47, pika 5, të ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira nr. 82, nr.83 dhe nr. 86, rezulton të ketë mbi 15 vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me “përvojën specifike profesionale” evidentohet se plotësohen kriteret profesionale pasi ka gjykuar dhe punuar në fushën e të drejtës administrative dhe civile. Nga të dhënat që disponojmë rezulton se kandidatja, deri në momentin e kandidimit, plotëson kriteret mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative, si dhe në fushën e të drejtës civile, të parashikuara këto në vendimet e Këshillit nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86.

Gjithashtu, për këtë kandidate është verifikuar për ekzistencën e një mase disiplinore dhe nuk u konfirmua një e tillë.

Përpos kësaj është verifikuar edhe fakti i “papajtueshmërisë ambientale” në rast kandidimi në Gjykatën e Lartë dhe nga aktet që disponohet, nuk u verifikua që ajo ndodhet në një situatë papajtueshmërie ambientale në rastin e ngritjes së saj në detyrë dhe përfundimisht, në mbledhjen e datës 15.06.2020 relatori ia kalon Komisionit, i cili ka vendosur ta kalojë për shqyrtim në mbledhjen plenare, duke konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur dhe bashkëlidhur është depozituar edhe projekt-akti, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr.86, datë 26.02.2020. 3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në procedurën e votimit, duke filluar me relatorin, anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe më pas anëtarët e Këshillit.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, relator i të cilit është zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, zonja {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 26.02.2020, konkretisht ka kandiduar për për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 82 dhe nr. 83 që janë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionin nr. 85 që është në fushën e të drejtës civile.

Lidhur me verifikimin e tre kritereve të kandidimit, sa i përket “përvojës së përgjithshme profesionale”, zonja {...} ka filluar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, fillimisht për stazhin profesional ku ka marrë emërimin e përkohshëm në janar 2003 dhe ka vijuar përgjatë të gjithë periudhës edhe sot në detyrën e gjyqtares.

Referuar akteve të emërimit në detyrë që disponohen edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton që zonja {...} të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale. Në këtë rast, duhet të mbani në konsideratë se nuk është përfshirë një periudhë prej gati 2 vjet e gjysmë, gjatë të cilës, me leje të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja {...} ka kryer studime jashtë vendit.

Sa i përket “përvojës specifike profesionale”, zonja {...} plotëson për të dy fushat e të drejtës përvojën specifike. Për këtë, sipas të dhënave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtares, por edhe nga Gjykata e Lartë ku zonja {...} ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore, rezulton që, për përvojën specifike në fushën e së drejtës administrative, në vitet 2008-2009, zonja {...} ka qenë në seksion administrativ, ndërkohë që për vitet 2014, 2015, 2016, zonja {...} ka qenë ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë dhe ka asistuar një gjyqtar që ka qenë në kolegjin administrativ të kësaj gjykate. Vetëm kaq, përmbush nevojën specifike prej 5 vjetësh në Gjykatën e Lartë, sa i përket kandidimit të zonjës {...} për pozicionet në fushën e të drejtës administrative.

Sa i përket përvojës specifike në fushën e të drejtës civile, mund të evidentoj vetëm periudhën nga 2008-ta e këtej, ndërkohë që ka përvojë specifike në këtë fushë edhe përpara vitit 2008, që gjatë vitit 2008-2009, ndërsa ka qenë në seksionin administrativ, për të plotësuar ngarkesën e gjyqtarëve, sipas statistikave të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që krahas çështjeve administrative, ka gjykuar edhe çështje në lëndë civile.

Ndërkohë, pas përfundimit të ushtrimit të detyrës së ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë, pra viti 2007 e në vijim, {...} është në seksionin civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Mjaft kjo periudhë, duke hequr 1 vit që ka kryer studime jashtë vendit, plotëson përvojën specifike 5-vjeçare në fushën e të drejtës civile, sa i përket kandidimit të zonjës {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me mospasjen masë disiplinore në fuqi është marrë vetëdeklarimi i zonjës {...} që deklaron që nuk ka masë disiplinore, po kështu është marrë konfirmimi edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ku rezulton që të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale. Rezulton që është bërë vetëdeklarim që nuk ka papajtueshmëri ambientale nëse emërohet në detyrë në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që nuk ka ndonjë të dhënë tjetër që mund të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse emërohet në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Nisur nga kjo, si relator i çështjes, kam përgatitur projektvendimin, nëpërmjet të cilit i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet si më lart përmenda. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim në projekt-aktin e relatuar, kalojmë në votimin e tij sipas procedurës, nga relatori, tek anëtarët e Komisionit dhe më pas tek anëtarët e Këshillit.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr.82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...”, projekt-akt i cili është përgatitur nga relatori, zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Zoti {...} ka kandiduar për dy pozicione të lira, që janë të dyja në fushën e të drejtës administrative, pozicione këto që janë shpallur me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83 të datës 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket tre kriterëve për të cilat është realizuar verifikimi, rezulton që zoti {...} të ketë përvojë të përgjithshme profesionale mbi 13 vjet, siç kërkohet nga Kushtetuta dhe

ligji për Statusin e gjyqtarit. Për këtë është marrë informacion pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nga rezulton që karrierën gjyqësore, kandidati zoti {...}, e ka filluar nga shtatori i vitit 2004, kur ka marrë emërimin provizor për stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe më tej, ka marrë edhe emërimin definitiv, po në këtë gjykatë, ku ka vazhduar deri në nëntor të vitit 2013, kohë kur është emëruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nisur nga kjo përvojë, rezulton që të ketë mbi 13 vjet.

Sa i përket përvojës specifike për fushën e të drejtës përkatëse ku ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, mjafton vetëm përvoja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë prej nëntorit të vitit 2013, që të plotësojë kriterin e “përvojës specifike” 5-vjeçare.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore” është marrë vetëdeklarimi nga ana e kandidatit që deklaron që nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe që është konfirmuar edhe nga të dhënat që disponohen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku nuk rezulton që të ketë masë disiplinore në fuqi.

Po kështu, është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Kandidati ka bërë vetëdeklarimin për mosndodhjen në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rastin e emërimit të detyrë në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që nuk ka ndonjë të dhënë tjetër që mund të ndodhet në këtë situatë, sa i përket kandidatit, zotit {...}.

Nisur nga sa më lart, në cilësinë e relatorit, i kam propozuar Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e përmendura më lart. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në procedurën e votimit të projekt-aktit, duke filluar me relatorin, tek anëtarët e Komisionit dhe më pas me anëtarët e Këshillit.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.82, nr.85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.82, nr.85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga relatori Ilir Toska (Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Projekt-akti i radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati zoti {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë...” dhe sërish për këtë çështje, relator është zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Kandidati zoti {...}, ka kandiduar për një pozicion në fushën e të drejtës administrative, pikërisht atë të shpallur me vendimin nr. 82 dhe për dy pozicione në fushën e të drejtës civile, ato të shpallura me vendimet nr. 85 dhe nr. 86, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale, rezulton që për përvojën profesionale, zoti {...} të ketë filluar karrierës gjyqësore që prej shkurtit të vitit '96. Fillimisht, deri në maj të vitit '98, zoti {...} ka qenë në detyrën e ndihmësgjyqtarit, ndërkohë që nga maji i vitit '98 deri në qershor të vitit 2000 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Mbas qershorit të vitit 2000 deri në qershor të vitit 2003 ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, dhe më pas nga qershori i vitit 2003 e në vijim, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ka një periudhë shkëputjeje shkurt 2008 - qershor 2009, ku për shkak të një vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për “shkarkimin nga detyra”, vendim ky që është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, nuk e ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në këtë periudhë. Nga të dhënat, rezulton që të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale.

Sa i përket përvojës specifike, qoftë në fushën e të drejtës administrative dhe në atë civile, mjafton vetëm periudha e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë, deri në nëntor të vitit 2013, ku sipas informacioneve të marra nga Gjykata e Apelit Vlorë, kjo gjykatë nuk ka funksionuar me seksione dhe të gjithë gjyqtarët kanë gjykuar të gjitha çështjet, pavarësisht lëndëve, në lëndë civile, në lëndë administrative apo në lëndë penale. Nisur nga kjo, rezulton që kandidati të plotësojë edhe kriterin e përvojës 5-vjeçare, qoftë në fushën e të drejtës administrative dhe gjithashtu në fushën e të drejtës civile, pa përfshirë periudhën përpara vitit 2008, sa i përket përvojës në secilën prej këtyre fushave.

Për kandidatin është verifikuar edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Ka bërë vetëdeklarimin nga ana e tij, ku deklaroi se nuk ka masë disiplinore dhe që është konfirmuar edhe nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” dhe rezultoi që ka bërë vetëdeklarimin lidhur me këtë situatë, duke u shprehur se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale nëse emërohet në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që nuk ka ndonjë të dhënë që kandidati mund të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale nëse ai emërohet në Gjykatën e Lartë sipas kandidimeve respektive të tij.

Mbi këtë bazë, unë si relator i çështjesh i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.85 dhe nr.86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet si më lart. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin e propozuar, ftoj kolegët të votojnë sipas procedurës, me relatorin, tek anëtarët e Komisionit dhe më pas tek të gjithë anëtarët e Këshillit.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2020)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës¹.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:43 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

13. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Çështja e fundit e rendit të ditës caktimi i gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në funksion të kësaj pike të rendit të ditës është përpiluar një informacion për Këshillin “Mbi kërkesat për caktim gjyqtari të gjykatave të apeleve të juridiksionit të përgjithshëm, të patrajuara ende nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, informacion të cilin zoti Toska e relaton pas hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fillimisht zoti Toska propozon që të hidhet shorti Zoti Toska fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
2. Gjykatat e shkallës së parë nën

juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; 3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë; 4. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; 5. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Më tej gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Durrës; Gjykata e Apelit Gjirokastër; Gjykata e Apelit Vlorë; Gjykata e Apelit Korçë; Gjykata e Apelit Shkodër, dhe në fund Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 ose 3, në varësi të rezultateve të shortit.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti i çështjes nr. 1 gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: z. Artan Çupi dhe z. Rexhep Karaj. Ndërsa në shortimin e çështjes nr. 2, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Artan Çupi dhe Rexhep Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 8.

Për 3 çështjet e para, ato nr.1, nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Për çështjen nr. 4, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen dy gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që janë caktuar për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e provës dhe që kanë marrë atë, konkretisht gjyqtarët Albert Meça dhe Besnik Hoxha.

Për çështjen nr. 5, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, konkretisht: z. Petrit Çomo dhe znj. Alma Kolgjoka. Në shortimin e çështjes nr. 5 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Kastriot Gramshi dhe znj. Migena Laska.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Elizabeta Gjoni.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Enkeleida Hoxha.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Engjellushe Tahiri.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Besnik Hoxha dhe Albert Meça.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Ardiana Bera (relatore), Gerd Hoxha dhe Vjollca Spahiu (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, konkretisht: z. Edvan Veçani si dhe të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që është me leje lindjeje sipas informacionit më të fundit nga kjo gjykatë, konkretisht: znj. Nertila Kape.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale dhe civile, gjyqtari Xhevdet Lika.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: z. Ded Miri. Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që do të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, që rezultoi të ishte z. Xhevdet Lika. Ndërsa, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i kësaj gjykate, konkretisht: z. Edvan Veçani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Aurel Arapi (relator), Evdan Veçani dhe Olti Skrame (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që është ngarkuar më parë për gjykimin e saj, konkretisht: znj. Eda Kaja.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Paulin Çera.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: z. Sokol Pina si dhe të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, e cila ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga procedurat e shortit për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, kërkesë që është në shqyrtim e sipër, konkretisht: znj. Yrfete Shkreli. Ndërkohë, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Përmet, të mos përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z. Dritan Hasani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Shkëlzen Liçaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti

kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale dhe civile, gjyqtarja Blerta Çibuku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti. Gjithashtu të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që do të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, që rezultoi të ishte znj. Blerta Çibuku. Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, e cila ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga procedurat e shortit për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, kërkesë që është në shqyrtim e sipër, konkretisht: znj. Yrfete Shkreli, si dhe kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, nëse ai do të caktohet për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kjo gjë nuk ka ndodhur, kështu që o duhet të përfshihet në short z. Dritan Hasani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Pëllumb Vehbi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 3 në lëndë penale.

Fillimisht Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në veçanti kërkesën për çështjen nr. 1 dhe kërkesën për çështjen nr. 3.

Lidhur me kërkesën për çështjen nr. 1 rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ta ketë bërë në kushtet kur gjyqtarja e kësaj gjykate, znj. Ersida Bajgora ka qenë me leje barrë-lindje.

Ndërkohë, referuar shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton se gjyqtarja Ersida Bajgora është kthyer në detyrë.

Për rrjedhojë, nevoja në këtë rast e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për caktim gjyqtari nga gjykata të tjera për plotësimin e trupit gjykues nuk ekziston më, sa kohë në këtë gjykatë aktualisht ka gjyqtar për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore.

Lidhur me kërkesën për çështjen nr. 3 rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ta ketë bërë me arsyetimin se kjo çështje, në të cilën viktima është e mitur, duhet të gjykohet nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë të seksionit për të mitur, ndërkohë që për formimin e trupit gjykues në këtë rast gjykata është në kushtet e padisponueshmërisë së një gjyqtari, sipas gjykatës.

Referuar veprës penale për të cilën i pandehuri është për gjykim në rastin konkret, konkretisht sipas nenit 290/4 i Kodit Penal, që parashikon si dënim me burgim nga pesë deri në njëzet vjet, bazuar në nenin 13/3 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues duhet të formohet nga tre gjyqtarë. Një fakt i tillë konfirmohet edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndërsa informon se trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët Saemira Hila dhe Kostika Çobanaqi, duke qenë e nevojshme caktimi i një gjyqtari të tretë, që sipas gjykatës duhet të jetë nga seksioni i të miturve, meqenëse në këtë gjykatë nuk ka gjyqtar tjetër të këtij seksioni që të mos ketë pengesë ligjore për gjykimin e çështjes, por vetëm dy gjyqtarë të tjerë të cilët nuk janë në seksionin e të miturve.

Sipas paragrafit të parë të nenit 28 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, “Nëse viktima është i mitur dhe gjykimi në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit bëhet me trup gjykues, të paktën një gjyqtar duhet të jetë i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur”.

Duke ardhur në rastin konkret, sipas informacionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në përbërje të trupit gjykues ka gjyqtarë të seksionit të të miturve në atë gjykatë, çka përmbush kërkesën e nenit 28/1 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ndërkohë që trupi gjykues në këtë rast mund të formohet edhe me një nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë që nuk bëjnë pjesë në seksionin për të mitur të kësaj gjykate dhe që nuk ka pengesë ligjore për gjykimin e çështjes.

Ndërkohë, pas komunikimit me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë për marrjen e informacioneve të nevojshme për këtë çështje gjyqësore në funksion të trajtimit të kërkesës së saj për caktim gjyqtari, kjo gjykatë, me e-mailin e datës 18.06.2020, ka tërhequr kërkesën për caktim gjyqtari në këtë çështje.

Në këto kushte, bazuar në nenin 94 të Kodit të Procedurave Administrative, për të dy këto çështje, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar.

Pra për këto dy raste, Komisioni propozon që Këshilli të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të: 1) kërkesës nr.91, datë 24.02.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me objekt - “Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitblerjes, etj.”. 2) kërkesës nr.160 prot., datë 22.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për caktimin e një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes ku i pandehuri është akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal.

Meqenëse nuk ka kundërshtime nga anëtarët e Këshillit, propozimi i Komisionit konsiderohet i miratuar.

Propozimet e Komisionit për 2 çështjet e tjera janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2 (një 1 për secilën gjykatë).

Për çështjen nr. 2, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndërsa për çështjen nr. 4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit për të Mitur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, konkretisht: z. Durim Hasa.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Adelajda Gjuzi.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Igerta Hysi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: z. Arbër Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Besmir Stroka.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Tonin Stërkaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetare) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, konkretisht: znj. Alma Ahmeti (Zhupa).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Merita Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë të punës, si dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i kësaj të fundit dhe konkretisht: z. Erjon Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):
Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Erjon Çela dhe Sami Ujkashi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetare) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, konkretisht: znj. Alma Ahmeti (Zhupa), si dhe të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës që do të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, që rezultoi e përzgjedhur gjyqtarja Merita Karaj. Si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë të punës, si dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e kësaj të fundit dhe konkretisht: znj. Flutura Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Florin Demollari dhe Flutura Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 3 në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të për zgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: z. Astrit Kalaja, si dhe gjyqtari i kësaj gjykate z. Aleks Nikolli i cili, sipas informacioneve të marra nga Gjykata e Apelit Shkodër, ka disa javë që është në pamundësi shëndetësore, ndërsa ka depozituar pranë asaj gjykate raport mjekësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Selim Kryeziu (relator), Valbona Vata dhe Vojsava Osmanaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Valbona Vata (relatore), Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pesëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të për zgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 4 çështjeve gjyqësore (për të cilat kërkohet nga 1 dhe 3 gjyqtarë), të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët Sokol Ngresi (relator), Nazmi Troka dhe Hysen Saliko (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Hysen Saliko.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeje gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe numri i gjyqtarëve të jetë 5 (2 nga Gjykata e Apelit Korçë dhe 3 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar).

Për çështjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, për të cilat kërkohet nga 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë.

Për çështjet nr. 4 dhe nr. 5, për të cilat kërkohen nga 2 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë rast, relatori i caktuar për çështjen nr. 5 nuk caktohet për çështjen nr. 4.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, në çështjen nr. 4 propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Nertina Kosova si dhe, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e kësaj gjykate, konkretisht: znj. Etleva Temo.

Propozohet që të përfshihet edhe zonja Margjeka e cila është e komanduar në

skemën e delegimit pranë kësaj gjykate.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Etleva Temo.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Mimoza Margjeka.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtaret Etleva Temo dhe Mimoza Margjeka.

(Shorti për çështjen e katërt dhe të pestë ripërsëritet pasi gabimisht ishte përfshirë gjyqtarja Nertina Kosova e cila duhej përjashtuar nga shorti, si rrjedhojë rihidhet shorti edhe një herë për çështjen nr. 4 dhe nr. 5.)

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Sokol Binaj dhe Albana Boksi

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Dhimitër Lara (relator), Sokol Binaj dhe Albana Boksi (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, 5 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 6 çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 6 (3 nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe 3 Gjykata e Apelit Tiranë.).

Për çështjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, për të cilat kërkohen nga 2 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këtë rast një gjyqtar nuk mund të caktohet në më shumë se dy çështje.

Për çështjet nr. 4, nr. 5 dhe nr. 6, për të cilat kërkohen nga 1 dhe 3 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast një gjyqtar nuk mund të caktohet në më shumë se 2 çështje.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, në çështjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, e cila është

anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: znj. Miranda Andoni. Në çështjet nr. 4, nr. 5 dhe nr. 6 propozohet që të përjashtohen nga shorti: Kryetari në detyrë (zëvendëskryetari) i Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Ridvan Hado; gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që nuk janë në detyrë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht: znj. Evjeni Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni; gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë për të cilët procesi i rivlerësimit kalimtar është në fazën e seancës dëgjimore, konkretisht: znj. Shpresa Beçaj, ndërsa për znj. Fatmira Hajdari sot është shpallur vendimi nga KPK. Ndërkohë duhet të përjashtohet edhe kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë z. Dritan Banushi, referuar rregullit të vendosur në vendimin e KLGJ “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Izet Salaj dhe Irena Brahimi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Enton Dhimitri dhe Izet Salaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Edlira Petri (relatore), Artur Gaxha dhe Alaudin Malaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 6, civile, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Artur Gaxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 3 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Për nevojën e paraqitur nga Gjykata e Apelit Shkodër në rastin e çështjes nr.3, kjo ka ardhur për shkak të mosparaqitjes në detyrë të gjyqtarit Aleks Nikolli, i cili ka depozituar disa raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme për punë. Aktualisht, sipas informacionit më të fundit nga kjo gjykatë, gjyqtari Aleks Nikolli ka depozituar një raport

mjekësor sipas të cilit ai është i paaftë për punë deri më datë 30.06.2020. Nga komunikimet e gjykatës me këtë gjyqtar, duket sikur e njëjta gjë mund të ndodh përsëri. Ndërkohë kjo çështje gjyqësore është në lëndë penale, ku i pandehuri është i paraburgosur për një krim të rëndë. Përveç kësaj, kjo çështje është regjistruar më datë 12.11.2019 dhe, sipas informacioneve të Gjykatës së Apelit Shkodër, për shkak të moszhvillimit të gjykimit nga mosformimi i trupit gjykues, rrezikohen afatet e paraburgimit të të pandehurit.

Në kushtet kur për çështjen nr.3 konstatohet se gjyqtari Aleks Nikolli nuk ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, ndërsa nuk ka vendim të organeve gjyqësore për largimin e tij nga gjykimi i kësaj çështjeje (miratim dorëheqje ose përjashtim), mund të konkludohet se nevoja e Gjykatës së Apelit Shkodër në këtë rast nuk ekziston. Qenia e një gjyqtari me raport mjekësor nuk përbën shkak për përjashtimi nga gjykimi i një çështjeje gjyqësore konkrete. Për rrjedhojë, në këtë rast, nuk jemi para rastit të mungesës apo padisponueshmërisë së gjyqtarit për të gjykuar çështjen, në kuptim të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Fillimisht, refuzimi i kërkesës së Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e një gjyqtari në gjykimin e kësaj çështjeje, pra çështja nr. 3 në tabelë.

Kërkohej që Këshilli të vendosë refuzimin ose jo të kësaj kërkesë e më pas të vijohet me propozimet e tjera të Komisionit, referuar çështjeve të tjera të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër sepse nuk mund të tolerohet dhe nuk mund të lejohet nga Këshilli që të kalojnë afatet e paraburgimit për çfarëdo lloj arsyeje. Gjyqtari mund të marrë raport për një periudhë të papërcaktuar kohore. Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka gjyqtarë të tjerë që të bëjnë plotësimin e trupit gjykues. Ka një periudhë shumë të gjatë që çështja është e pashqyrtuar, prandaj vlerësohet që në këtë rast duhet të bëhet caktimi i një gjyqtari nga gjykatat e tjera.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Të vijohet me trajtimin e tre kërkesave të tjera të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke mos përfshirë çështjen nr. 3, që është varianti i dytë i propozuar në relacion.

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2 (1 nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 1 nga Gjykata e Apelit Tiranë).

Për çështjet nr. 1 dhe nr. 2, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, të caktohet 1 i tillë, i cili të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për çështjet civile nr. 4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë që është në të njëjtin trup gjykues me dy gjyqtarët e kësaj gjykate të caktuar më herët me short për gjykimin e kësaj çështje, znj. Flutura Skënderi.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, në çështjen nr. 1 dhe nr. 2 propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z. Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, dhe çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 3, penale, u përjashtua/refuzua nga shorti.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Flutura Skënderi (sipas propozimit në

relacion).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeve gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që janë caktuar në shortet e mëparshme, për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Alma Kolgjoka dhe znj. Ornela Naqellari.

Gjyqtarët që plotësojnë kriteret si më lart janë: Enton Dhimitri; Margarita Buhali; Artur Kalaja; Astrit Kalaja; Dritan Banushi; Miranda Andoni; Manjola Xhaxho; Alma Kolgjoka; Ornela Naqellari; Esmeralda Xhili (Çeka); Rexhep Bekteshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Rexhep Bekteshi (relator), Enton Dhimitri dhe Esmeralda Xhili.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për të gjitha gjykatat.

Ndërkohë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vënë në dispozicion edhe një informacion për kërkesat e paraqitura nga gjykatat e apelit me juridiksion të

përgjithshëm, që nuk janë përfshirë deri më sot për trajtim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (nuk janë kërkesa të karakterit urgjent apo tepër urgjent, apo që kanë të bëjnë me persona të paraburgosur).

Gjithsej janë të patrajuara 39 kërkesa të tilla. Ndërkohë, nga data 20 shkurt e deri më sot nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë paraqitur 106 kërkesa, Këshilli ka trajtuar, përfshirë edhe ditën e sotme 67 të tilla. Kanë mbetur pa trajtuar 39 kërkesa, të cilat 18 janë për çështje civile dhe 21 janë për çështje penale.

Konkretisht janë 14 kërkesa të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, nga të cilat 9 për çështje civile dhe 5 për çështje penale; janë 10 kërkesa të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të cilat 4 për çështje civile dhe 6 për çështje penale; kanë 8 kërkesa të Gjykatës së Apelit Durrës, nga të cilat 2 për çështje civile dhe 6 për çështje penale; dhe 7 kërkesa të Gjykatës së Apelit Korçë, nga të cilat 3 për çështje civile dhe 4 për çështje penale.

Nga informacioni me shkrim, janë edhe objektet dhe referencat e kërkesave të paraqitura nga secila gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm.

Referuar të dhënave si më lart, sipas 39 kërkesave ende të patrajuara nga Këshilli, rezulton që gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm të paraqesin nevojë për caktimin 73 gjyqtarëve.

Vijon të lexohet informacioni nga zoti Toska:

Sikurse jeni në dijeni, aktualisht, numri i gjyqtarëve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm është 63, nga të cilët në detyrë janë vetëm 43 (në fakt pas ditës së sotme janë vetëm 42), pra janë më pak se 55% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të këtyre gjykatave (që sipas dekretit të Presidentit të Republikës, sipas legjislacionit të mëparshëm, numri i përgjithshëm është 78).

Për rrjedhojë, vetëm në funksion të trajtimit të 39 kërkesave të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Këshilli do të duhet të caktojë gati në 2 çështje secilin nga gjyqtarët aktualisht në detyrë në këto gjykata.

Ndërkohë, reduktimi i numrit të gjyqtarëve të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka çuar në rritjen e stokut të çështjeve të pagjykuara në këto gjykata dhe të kohëzgjatjes së gjykimit të tyre. Konkretisht, stoku i çështjeve të pagjykuara në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm paraqitet si vijon:

1) Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 5919 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2016;

2) Gjykata e Apelit Vlorë në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 2823 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2017;

3) Gjykata e Apelit Durrës në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 2130 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2018;

4) Gjykata e Apelit Shkodër në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 1238 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2017;

5) Gjykata e Apelit Gjirokastrë në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 349 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2019;

6) Gjykata e Apelit Korçë në vitin 2020, ka mbartur gjithsej 227 çështje, ku më të hershmet e tyre janë regjistruar në vitin 2019.

Është fakt i njohur publikisht se prej gati një viti apo më shumë, të gjithë gjyqtarët aktualisht në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë në proces rivlerësimi kalimtar, ku për disa ka përfunduar faza e hetimit administrativ dhe janë thirrur në seancë dëgjimore nga organet e rivlerësimit, ndërsa për disa të tjerë duhet të jetë duke përfunduar faza e hetimit administrativ ose për ndonjë ka përfunduar dhe janë në pritje për t'u thirrur në seancë dëgjimore nga organet e rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces që kërkon një angazhim serioz të gjyqtarëve, çka është e kuptueshme që ka çuar në mungesë përqendrimi dhe produktiviteti të tyre në veprimtarinë e përditshme gjyqësore.

Pra, aktualisht, gjyqtarët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm aktualisht në detyrë përballen me një ngarkesë serioze në gjykatat ku janë të caktuar në mënyrë të përhershme, ndërkohë që prej më shumë se një viti ata janë caktuar nga Këshilli në jo më pak se 20 çështje në gjykata të tjera të ndryshme, përveçse gjatë kësaj periudhe kanë qenë në proces rivlerësimi kalimtar dhe është e pritshme përfundimi i këtij procesi për ata.

Nisur nga kjo situatë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerësoi të informojë Këshillin në lidhje me kërkesat e patrajuara ende të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, me qëllim për të vlerësuar ai për mënyrën e të vepruarit në këto raste, por edhe në raste të ngjashme që patjetër do të paraqiten në vijim. Faleminderit!

Në fund të shqyrtimit të këtij informacioni, kërkon fjalën **zoti Toro** i cili kërkon që nëse do të ishte e mundur që Këshilli t'i rikthehej edhe një herë një gjykimi në Korçë, një treshe në të cilën në dijeninë e tij, do të ishte më mirë që të riformatohej për hir të punës (relatore e çështjes ishte zonja Sadushi ose Petri). Zoti Toro kërkon nëse është e mundur të rihidhet edhe një herë në short?

Zonja Kadi kërkon që të sqarohet se për çfarë bëhet fjalë.

Zoti Toro thekson se sqarimet bëhen kur ke diçka të shkruar dhe aktualisht zoti Toro nuk ka përgatitur diçka të shkruar.

Zoti Toska, në përgjigje të zotit Toro, shprehet se procedurat e shortit janë mbyllur dhe nuk do duhet t'i rikthen sërish.

Në lidhje me relatimin e bërë nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës lidhur me kërkesat për caktim të çështjeve në gjykatat e apelit të jurisdiksionit të përgjithshëm, merr fjalën **zonja Ukperaj** e cila me sa ka kuptuar janë të gjitha kërkesa të çështjeve me lëndë civile dhe penale, por me pa të paraburgosur. Numri është shumë i konsiderueshëm. Zonja Ukperaj propozon që të bëhet një renditje të çështjeve sipas kronologjisë së regjistrimit, duke iu dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve që janë regjistruar më përpara në kohë. Pra kërkesa ka nga të gjitha gjykatat e apeleve dhe duhet të marrin prioritet gjykimet e çështjeve që janë më të vjetra në regjistrim. Në qoftë se ka çështje të 2016, ato duhet të shqyrtohen më përpara. Të mbarojnë këto e më pas të shqyrtohen çështjet e 2017.

Zoti Toska është i paqartë sa i përket vjetërsisë së regjistrimit që i referohet zonja Ukperaj. Secila gjykatë ka vjetërsinë e saj. Informacioni ishte sa i përket stokut: Gjykata e Apelit Tiranë e ka stokun duke filluar nga viti 2016; Gjykata e Apelit Vlorë e ka duke filluar nga viti 2017; Gjykata e Apelit Shkodër e ka duke filluar nga viti 2017; Gjykata e Apelit Durrës e ka duke filluar nga viti 2018 dhe vetëm Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Korçë e kanë duke filluar nga viti 2019. Nëse kërkesat paraqiten nga gjykata të ndryshme, kujt vjetërsie duhet t'i referohet Komisioni që ta sjelli për trajtim në Këshill?

Zonja Ukperaj propozon që ndoshta të ndërtohet një kalendar duke filluar nga një grup çështjesh që janë regjistruar më herët në gjykatë, -kjo ishte ideja e zonjës Ukperaj.

Nëse do të trajtohen disa kërkesa të gjykatave të apeleve, që janë për çështje civile, të mos trajtohen të gjitha njëherësh, duke pasur parasysh numrin e reduktuar të gjyqtarëve të gjykatave të apeleve dhe ngarkesën e gjykatave respektive që ata kanë, plus procesin e vetingut, të përzgjidhen qoftë 10 çështje (ose sa të vlerësojë Komisioni), duke filluar nga ato që janë regjistruar më përpara në gjykatë.

Konkretisht *zoti Toska* thekson se Gjykata e Apelit Gjirokastrë apo edhe e Korçës i kanë çështjet e regjistruara shumë më të vonshme në raport me të gjithë gjykatat e tjera, ndaj çfarë do të bëhen me këto çështje? Vjetërsia në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Korçë është shumë e vonshme.

Zonja Ukperaj sërish thekson se shqetësimi lidhet me faktin që janë shumë çështje për delegim dhe janë shumë pak gjyqtarë, ndaj duhet ndërtuar një strategji sepse çështjet s'mund të lihen pa shqyrtuar. Ndërkohë, në të njëjtën kohë, nuk mund të caktohen gjyqtarë në të gjitha çështjet sepse nuk do gjykojnë dot as tek gjykatat e tyre dhe as tek gjykatat ku do caktohen. Atëherë, kjo strategji që zonja Ukperaj propozon është që, nëse Gjykata e Apelit Korçë dhe apelit Gjirokastrë i kanë çështjet më të reja të ardhura, të qëndrojnë në listë pritjeje (nëse çështja nuk është urgjente) dhe të fillohet me delegimin në gjykatat që çështjet i kanë urgjente. Për shembull, në qoftë se ka një çështje të regjistruar në vitin 2016 ose në vitin 2017, duhet të marrë prioritet gjykimi nga ato që regjistrohen në vitin 2020. Kjo është ideja e zonjës Ukperaj.

Anëtarë të tjerë nuk kanë diskutime mbi çështjen, ndaj zonja Llagami fton anëtarët e Këshillit që të reflektojnë mbi situatën e raportuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozimin që bëri zonja Ukperaj dhe më pas këto reflektime të jenë pjesë e diskutimeve në mbledhjen e ardhshme. Anëtarët e Këshillit janë dakord.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor